

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIX i botimit, nr. 225, Korrik 2022

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro


## YLBERI PËRMBI SHOSH, NJERËN DORË NË BRASHTË DHE TJETRËN NË PALAJ

**2** Me propozim të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Presidenti i Republikës së Shqipërisë, zoti Ilir Meta, me datën 12 korrik 2022, ka dekoruar Dom Prekë Ndrevashen, pas vdekjes me titullin "Kalorësit i udhrit të Skënderbeut" dhe artisten Rita Ndoci, me titullin "Mjeshtër e Madhe"



Me 21 korrik 1925-  
Lindi, Martin Camaj,  
shkrimtar dhe  
akademik shqiptar

- Në kuadrin e 97 vjetorit  
të lindjes së Martin  
Camaj - Nderi i Kombit -



## HAPJA E SEZONIT TURISTIK DHE FESTË NË THETH

**5**

*"O udhëtare që shkon në Shkodër mos ndalo aty. Ngjitu më lart dhe vetëm atëhere do ta kuptosh se kush është Shkodra"* - **Idro Montaneli**

Emri Theth tingëllon si sinonim i bukurisë. Duhet vënë në dukje se akoma Thethi nuk është eksploruar sa duhet, prandaj çdo aktivitet kushtuar kësaj perle ka vlera njothje edhe për pjesën tjetër të Dukagjinit, ende më shumë për ta promovuar. Veprimtaria e organizuar me datën 2 Korrik nga Bashkia Shkodër, duhet vlerësuar në shumë komponentë, në këtë mbarëvajtje ka meritën e saj të drejtimit krahas personave të tjerë, edhe znj. Aurora Piroviq.

Përpara teatrit "Migjeni" bëhet nisja e organizuar me automjete, por falë "korrektësisë" në masë që ...



## Pulti kujton dhe promovon, festa e "Qereshit-2022"

Vijon tradita e veprimtarisë "FESTA E QERESHIT", traditë kjo e rrenjësuar dhe mbeshtetur në vite nga banorët e zonës, Bashkia Shkodër dhe së fundmi GIZ Albania.

Më datë 15 korrik 2022, është organizuar "Festa e Qereshit", përkujtimi i luftës së popullit të Planit, 107 vjet më parë kundër pushtuesit serbo-malazez, program artistik, promovimi i resurseve të zonës dhe eksplorimi i bukurive natyrore, panairi i produkteve ushqimore të traditës, ishin elementet që pasuruan këtë veprimtari.

Në fjalën e hapjes, z. Tom Marku administrator i njësisë Pult, përshëndeti të pranishmit duke theksuar rëndësinë e promovimit të Pultit, produkteve, natyrës e të gjithë historisë së krahinës të kësaj krahine.

**9**

# Ylberi përmbi Shosh, njerën dorë në Brashtë dhe tjetrën në Palaj

**Me propozim të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, zoti Ilir Meta, me datën 12 korrik 2022, ka dekoruar Dom Prekë Ndrevasjen, pas vdekjes me titullin “Kalorësit i udhrit të Skënderbeut” dhe artisten Rita Ndoci, me titullin “Mjeshtër e Madhe”**

## Kush ishte Dom Prekë Ndrevashaj?

DOM PREKË NDREVASHAJ, NJË NGA PRIJËSIT MË TË NDERUAR TË SHQIPTARËVE TË AMERIKËS!

*Një jetë në shërbim të idealeve më të epërme njerëzore (patriot, mësues klerik, misionarë humanist, antikomunist, publicist, poet novelist dhe shqiptarë i madh)*

*Dom Preka dëshmoi me vepra se, ai është një bari i zellshëm, i papërkulur dhe që nuk i trembët pengesave, madje në ato kundërshti ai kaloi durimin dhe me dritën e Krishtit gjën shtegun e duhur, për t'ia arritur qëllimit. Njeri organizator, i buzëqeshur, që me një fjalë e largon frymën e urrejtjes dhe të ndarjes. Ai fal shpejt dhe shëroi shumë zemra të plagosura. Mbi të gjitha, Dom Preka manifeston tiparet e kullës së Dukagjinit dhe pastërtinë e ligjeve të maleve tona.*

**Mons. Dr. Zef Oroshi, bashkëkohës i Dom Prekës dhe kapelan i parë i Kishës Katolike Shqiptare në Amerikë, shkruan:** “Nuk mund t’ua heqësh të drejtën klerikëve për të qenë patriotë e atdhetarë, për të drejtuar e prirë si çdonjëri prej nesh. “Të jemi kryelartë që e kemi pasur një njeri si Dom Preka midis nesh”.

**Ekrem Bardha, Konsulli i Nderit për Michiganin, thekson:** “Ne ishim, gegë e toskë, myslimanë, bektashinjë, katolikë e ortodoksë, të gjithë shqiptarë. Rrugëve të botës, por të gjithë të bashkuar dhe të lumtur për shoqërinë dhe miqësinë që kishim me njëri tjetrin si shqiptarë pa dallim, rreth një prifti katolik, dom Preke Vashaj, i cili përpiqej të ndihmonte të njohurin e të panjohurin, vetëm a ishte shqiptar...”.

**Frank Shkreli gazetar dhe redaktor në “Zërin e Amerikës” dhe shef i seksionit shqip, thekson:** “Si klerikë shqiptarë, pavarësisht nga besimet e ndryshme që kishim, me të ndjerin Dom Prekë Ndrevashaj na lidhi një miqësi e sinqertë dhe aspak formale. E them dhe e nënvizoj këtë fakt që të dy, duke qenë përkatësisht të të njëjtit brez, kemi qenë edukuar nga mësuesit tanë me ndjenjën e bukur të dashurisë për fenë e gjithashtu për Atdheun tonë të dashur, Shqipërinë”.

**Imam Vehbi Ismaili, bashkëkohës, thekson:** “ Dom Preka ka qenë meshtar dhe ka krijuar një brez dhe formuar njerëz të rinj. Gjithë të këqijat në botë vinë nga njerëzit e jo nga Zoti e pikërisht për të formue njerëz të mirë, të dashur, njerëz të rinj me besim në zotin, pikërisht për atë, ka punua gjatë tanë jetës Dom Preka”.

**Dom Fred Kalaj, thekson:** “Deviza e Dom Prekës ishte lutja shumë domethënëse: “O Zot, bashkona kudo që jena me dashurinë tënde!”

**Dr. Gjekë Gjellaj, thekson:** “Dom Prékë, ka m’u trashiguar si gojëdhënë Bëshkëve të Tija!...Sado që të përsh-



kruhet si i madh në shpirt e me ndjenja tipike të pasuesit të Jezuit, kurrë as nuk kanë me iu afrua përshkrimit të shpirtit që ndryente ai kraharor njërit fizikisht imcák. Në këtë aspekt Dom Preka ishte vërtet një vigan!”

**Mërgim Korça, thekson:** “Dom Preka i shërbeu Zotit dhe u lut për ne, i shërbeu gjuhës dhe traditës, u shërbeu shqip-

tarëve të gjakut të tij, krijoi famullinë e parë këtu, edhe pse në disa raste u sulmua dhe u pengua bash nga ata që i ndihmoi. Tri dashuri të mëdha kishte Dom Preka: Popullin, Fenë dhe Atdheun!”

**Dom Ndue Gjergji pasues i Dom Prekës, Jetëshkrimi:**

Dom Preke Ndrevashaj, lindi në Brashtë të Shoshit me 24 qershor 1928,

filiz i trugut të vjetër të Ndrevashtës, vllaznie parike, që cila i dha Dukagjinit babanë e ndores shqiptare Marash Tuci, i flijuar me 1806 pas një qëndrese epike me forcat turkoshake në Pazarin e Shkodrës.

Erdhi në jetë nga prindërit Sokol Prekë Sokoli (Ndrevashaj) dhe Mire Nikja (Vuksanj) nga shtëpia e mirënjohur e Sadri Lukës, Can Tahirit dhe Prel Nikës së Thethit. Konak i madhe shumë mbresëlënëse edhe për udhëtarin amerikane Rose Wilder Lane.<sup>1</sup>

Mësimet e para i mori në vendlindje, nga prifti gjerman Dom Alfons Tracki.<sup>2</sup>

Më pas ndoqi Kolegjin Papnore Saverjane të etërve jezuitë në Shkodër së bashku me Martin Camajn, Lukë Kaçajn, At Zef Pellumbin, Dom Ernest Troshanin, Dom Simon Jubanin e të tjerë.

Në Kolegj shërbeu si diakon ku ditët e fundit të Luftës së Dytë Botërore me At Marin Sirdanin patën strehuar Lef Nosin e At Anton Harapin më 1945. Në seminar mori dëshminë e maturës për shkak të mbylljes së këtij institucioni nga komunistet nuk mundi të vijonte më tej studimet, prandaj u detyrua të strehohet në Tiranë tek Padër Pjetër Mëshkalla, i cili e paraqiti si shërbëtor.

Pas zikzakëve të mundimshme e thërrasin të kryente shërbimin e detyruar ushtarak në Burrel. Vendi kishte nevojë për mësues, prandaj me anën e ca miqve mundit të fillonte pune si mësues në Dajç të Zadrimës dhe më pas në fshatin Ulanjet të Klosit, në rrethin e Matit.<sup>3</sup>

**Djaloshi ëndërrimtar Prekë Ndrevashaj shumë shpejt do të rebelohej, duke kapërcyer përtej mureve të ngurta, duke shtegtuar si dallëndyshe drejt botës së lirë. Ka qenë viti 1952, kur trimërisht u arratis se bashku me nënë Marie dhe motrën Pashkë (Albana). Pasi u vendos në Guci hapi shkollën shqipe ku punoi për katër vite të plota shkollore.**

**Prej aty me ndihmën e legatës italiane, me 1956 emigron në Itali.** Atje me ndërhyrjen e Dom Zef Oroshit vijon studimet e larta teologjike në Kolegjin Propaganda Fide, Romë, dhe shugurohet meshtar më 1961, ku u brumos, u poq dhe gjithë jetën rrezatoi dritën e kulturës dhe lirisë oksidentale. Me 20 dhjetor të atij viti shugurohet meshtarë, nga Kardinali Agaginiani, Prefekti Kongregatës Propaganda Fide. Punoi për tre vjet kapelaon i motrave në Romë dhe pastaj zëvendës famullitare në Propaganda Fide.

<sup>1</sup> Rose Wilder Lane”Majat e Shalës Botimi dytë, Sh.B.Argeta Tirane viti 204, fq 131.

<sup>2</sup> Dom Zef Oroshi : Kryq-Tërthuer nepër Ujdhezat Karabjane, Shejzat v. X, nr. 9-12, Romë 1966. At Zef Pellumi,: Rrno vetëm për me tregue, Hylli i dritës, Tiranë 1995, f. 35

<sup>3</sup> Dom Prekë Lazri. Gazeta “Dukagjini” nr 11 tetor 2004.

Duke pare zellin e Dom Prekës, Selia e Shenjtë, e emëroi Kapelan i emigrantëve shqiptarë për Evropën, detyrë të cilën e përmbushi për 12 vjet, duke u bërë strehë dhe stacion i sigurt për mijëra e mijëra refugjatët shqiptarë të dëbuar nga Jugosllavia dhe “parashutistët” të vendosur nëpër kampe të Italisë së Veriut si dhe kalimi të tyre në kryeqendrën e botës së lirë në SHBA.

Pasi priti e përcolli, me bujari gjithë ata bashkatdhetarë, shkoi në SHBA më 1970, ku shërben në famullinë e Detroitit periudhë kur bashkëpunoi gjatë me Dom Zef Oroshin më të vjetrin e meshtarëve shqiptarë katolikë në SHBA.

Më 1976 themeloi kishën Zoja Pajtoresh shqiptare në Detroit, si qendra e dytë pas asaj të Nju Jorkut<sup>4</sup>. Drejtoi revistën “Rreze Shelbuese”, në Detroit, ku botoi shkrime e sidomos vjersha patriotike e fetare, në shtratin e traditës. Dom Preka përkujdeset vetë për shtypin e revistës duke i shoqëruar shkrimet me vizatime e tablo nga salvimi i klerit

Gazetari i vjetër i BBC në shqip, Frenk Shkreli, në lidhje me kontributin e dom Prekës në ndihmë të emigracionit shqiptarë ka shkruar: “Duhet të falenderojmë të Madhin Zot, që dërgoi në mesin tonë Dom Prekë Ndrevashajn — që përveç thirrjes së tij si meshtar për tu kujdesur për nevojat shpirtërore të popullit të vet — Ai pranoi të merrte përsipër gjithashtu edhe rolin për të vendosur fatin e mijëra refugjatëve shqiptarë të shpërndarë nëpër kampe të Italisë. Ai nuk kishte nevojë të pranonte një detyrë të tillë plot kokëçarje, pasi mund të shërbente si famullitar në ndonjë kishë të Romës dhe të kalonte një jetë në paq dhe pa turbullira.”<sup>5</sup>

Ish-udhëheqësi i Bektashinjve në Miçigam Baba Rexhepi me shumë nderim u tregon pasardhësve se -Dom Preka qe meshtari shembullor, bari i thjeshtë dhe shumë i përvuajtur, që punoi gjithë jetën si argat i shëlbimit. “Dom Preka i donte me gjithë shpirt, vëllezërit e motrat e tija shqiptare nga të gjitha viset e Shqipërisë, pa dallim feje, ndaj dashuria e pa kufijshme që ushqente për ta nuk kishte si të mos shpërblehej me dashuri të ndërsjellë”.

Papa Pali i VI-të në vitin 1967 u angazhua seriozisht për të përkujtuar 500 vjetorin e largimit nga Shqipëria të figurës së Zonjës së Shkodrës. Në këtë eveniment të rëndësishëm në emër të 250 shqiptarëve të mbledhur në sallën e Kremtimeve, përshëndeti dom Prek Ndrevashajn, i cili në prezencë të Papës Pali i VI-të pati deklaruar: **“Janë këtu para Shkëlqësisë Tuaj përfaqësuesit e tri besimeve fetare të popullit shqiptar, i cili nuk e harron ndihmën e dobishme që pati nga Papët e Selisë së Shënjtë si dhe Skenderbeu mbrojtësi i lirisë së atdheut e atlet i Krishtit. Sot në kohë më të kobshme e shumë më të trishtueshme se ato të periudhës së kaluar po e mendojnë popullin tonë të pafat, i cili ne shëmbullin e 15-të mbrojtës Evropën. Në këtë ditë të vështira, ky popull nuk dëshiron tjetër veçse një vend të vetin në familjen evropiane”**.<sup>6</sup>

4 Kisha e Zonjës së Këshillit të mirë “Nev York BKSH, Fq 158.

5 Artikulli i cituar nga libri “Kristale Dukagjini” i autorit Zef Prenga, botim i viti 2013, fq 5, 6 Zef Prenga “Kristale Dukagjini” i autorit,

Më 6 korrik të vitit 1992 Dom Preka, pas 40 vitesh kthehet në vendlindje. “Er-dhi përsëri edhe pas 12 vjetësh, u çmall me miq shokë të moshës së tij dhe vdiq në mënyrë krejt të pa pritshme me 1 tetor 2004, në Shkodër, aty ku e kishte lënë amanet miqve të vet në Amerikë ta varrosnin. Dom Preka u nda fizikisht nga kjo botë në moshën 76 vjeçare.

Imzot Rrok Mirdita, Ipeshkv i Durrësit e Tiranës në fjalimin mortor pat deklaruar *“Nuk është krejt e rastësishme që Zoti e thirri vëllai tonë pikërisht në vendin e vet. Tërë jeta e tij ka qenë e lidhur me dashuri të thellë, të singërtë e prekëse për Shqipërinë e shqiptarët”*.<sup>7</sup>

Intelektuali i shquar shqiptaro-amerikan Mërgim Korça, Rexhep Qosja dhe Mahmut Bakalli, kur mësuan lajmin e vdekjes së mësuesit të tyre shembullor do të shpreheshin: *“Lum për ne që e patëm Dom Prekën! Ai ishte një nga prijësit më të nderuar të shqiptarëve të Amerikës.”*<sup>8</sup>

**PREKË NDREVASHAJ POETI DHE NOVELISTI I JEZERCËS GJUHËSORE VERIORE**

Dom Prekë Ndrevashaj ishte një figurë elitare e inteligjencës sonë të mërgatës, njohës me thellësi filozofisë, sociologjisë, politologjisë dhe së drejtës. Zotëronte më së miri latinishten, italishten, serbo-kro-tishtën dhe anglishten

Emri i tij ishte i mirëpritur tek “Shejzat” e Koliqit, “Jeta Katolike” e Zef Oroshit, “Krahu i Shqiponjës” i Lidhjes Çame në Amerikë me botues Bilal Xhaferrin, tek “Dielli” i Vatrës, “Lidhja e Antonio Beluscit”, të arbëreshëve të Italisë e të tjera.

Në këtë shembull ai botoi revistën Rreze “Shelbuese” 1971

Dom Prekë Ndrevashaj shquhej për oratori të shkathet, ligjërimi metaforik produkt i leksikut të larmishëm dhe komunikimit me gjuhën e thjeshtë të emigrantëve tanë.

Krijimtarinë letrare e filloi herët, ishin kontaktet dhe diskutimet e tij të para me shokun e klasës së jezuitëve Martin Camajn.

“Nata e Buzmit”: Nihet si poezia e pare e botuar në Romë te revista “Shejzant” me pseudonimin Fuska duke vijuar me ciklet poetike:

“Tëshumtet”, “Mbishenat në dimër”, “Kah ja mbanjën kojrilat!”, “Dasëm Përte lumit”, “Tamarra za Marrun”, “Lamtumirë Kosovë”, “Malësia jonë”, “Krishtlindje pa vendlind” e “Amerিকা”

Dom Prekë Ndrevashaj, është shquar si një novelist, vazhdues i denjë i traditës letrare të vendlindjes së tij, në të cilën janë botuar disa novela me motive nga Shqipëria veriore.

Te “Shejzat” ka botuar edhe novela dhe poezi, të cilat nuk kaluan pa lënë gjurmë si novelat: “Mbishenat”, “Një pendim”, “Bluti i Helmuem”, “Guri i pushimeve” dhe “Kur çerdhja e Shqipeve”.

Poeti i tronditur me nota trishtuese përcjellë tajfunin shkatërrues komunist ndaj faltoreve të shenjëta të besimit në Shqipëri.

botim i viti 2013, fq 145

7 -Nga Fjalimi mortor i Imzot Rrok Mirditës Ipeshkv i Durrësit e Tiranës.

8 -Arti cituar nga gazeta “Dukagjini” nr. 11, tetor 2004.

**Kush është Rita Ndoci?**

**Titulli “Mjeshtër e madhe”**

Rita Ndoci, artiste rrezatuese shumë-planëshe e skenës shqiptare, humoriste gazsjellëse parodiste, fluturake, këngëtare simpatike, imituese revolucionare moderatore elokumente fytyrë e



qeshur impulsive e çiltër, pa komplekse, nder shembullore e veçanta e artit, adhuruese e madhe e të vëllait, këto janë impresionet që të dhuron Rita Ndoci jo vetëm në potin e artit sa po të futesh në bisedë me të.

Rita është fëmija i dytë në radhën e pinjove artist të familjes Kolë Mark Ndoci, e cila ka lindur me 24 prill 1963, është lidhur me shpërgaj e djepit kulmor të Shkodër Loces. Që në fëmijërinë e hershme, ëndërronte të bëhej aktore, të dilte në skenë dhe të kënaqte sa më shumë njerëzit.

Filloi të këndonte që kur ishte në kopsh nën instrukcionin e rreptë e dashmires të Frederikut. “Nga ai mësoj të këndonte dhe luante shah. Ka pas shumë qejf të shoqëronte Rrikun dhe gjithmonë i ka bërë zërin e dytë në këngët e tij. Bashkë me vëllain, Frederikun dhe motrën e saj Julin, improvizonin skena brenda në lagjen e tyre me anë të çarçafëve dhe jepnin shfaqje për fëmijët e lagjes. E gjithë kjo prirje që reflektohej nga motrat dhe vëllai një ditë do të kanalizohet në drejtimet e artit, pasi Frederiku dhe Juli do të bëheshin këngëtarë mjaft të dëgjuar jo vetëm në vetëm në vendin tonë, por edhe më gjerë. Siç ndodh zakonisht për talentet edhe Rita i pati fillimet e veta gjatë shkollës kur aktivizohet në Shtëpinë e Pioneerit. Pas shkollës tetëvjeçare Rita kalon në shkollën e mesme artistike “Prekë Jakova” në Shkodër për kanto. Në vitin 1981 ka kënduar për herë të parë me Frederikun në një koncert artistik.

-Në prill 1979 fillon aktivitetin artistik në shtëpinë e Kulturës Shkodër.

Që në hapat e pare e fillon me repertorin e kompozitorit Prenke Jakova, duke marr vlerësimin më të lartë. Krahas arieteve të programit shkollor të lëvroj edhe Jaren shkodrane, e cila teknikisht është shumë e vështirë për tu realizuar. Paradite pristë në shkollë, në mbrëmje merrej grykë me Teatrin “Migjeni” duke kënduar në estradën e qytetit dhe marre duartrokitjet e zjarra nga spektatori shkodran. Në konkurrimin me shkollat e tjera të muzikës, është vlerësuar me çmimin e

pare në konkursin e sopranove të reja që është zhvilluar në Durrës

-Në vitin 1980 këndon me orkestrën filarmonike të Shkodrës Arien e Donikës nga opera “Skënderbeu” te kompozitorit Prenke Jakova, nen drejtimin e dirigjentit Ermir Krantja. Për në këtë aktivitet, është nderuar me fletë nderi.



Në vitin 1981 marrë pjesë në “Festivalin e Këngës Qytetare Shkodrane” me një kënge të kompozuar nga Mark Kaftalli, e interpretuar me Frederikun, vlerësuar me çmimin e dytë.

1981 ka qene pjese e shumë koncerteve, duke kënduar Arie të repertorit Operistik Botëror dhe Shqiptar.

Në vitin 1982 ka zhvilluar një koncert recital spektakolar në Shkodër, në shkollën e Muzikës së bashku me Tedi Papavramin - Violinist.

Në vitin 1983 mbaroj shkollën e mesme artistike “Prenke Jakova” ku diplomohem në degën e Kantos si soprano, me nota të shkëlqyera.

Me 1 dhjetor 1983 filloi punë si mësuese në shkollën 8 vjeçare “Salo Halili”, degë e shkollës së muzikës, ku jepte lenden e solfezhit dhe Fizarmonikës. Çdo natë këndonte në estradën e qytetit si soliste në teatrin “Migjeni” dhe punonte për Jaren Shkodrane me mjeshterin e pa shoq Bik Ndoja.

Me 16 tetor 1983 paraqitet në Festivalin të Gjirokastrës ku Shkodra fitoi flamurin e festivalit dhe performanca e Rites me Jaren u zgjodh që të këndohej në Tirane, në koncertin përfundimtar në 16 Tetor 1983, e që organizohet me numrat më të zgjedhur e të arritur përpara Enver Hoxhës, në “Pallatin e Sportit” në Tiranë.

Në vitin 1983 fitoj dhe realizoj rolin tek filmi “Militanti”.

Me 15-18 nëntor të vitit 1983 në takimin e estradave në Shkodër, në shfaqjen e estradës së Shkodrës “Ditë buzëqeshjesh” të vënë në skenë nga Edmond Mëhilli, aktorja e re Rita Ndoci do të mahnitë spektatorin me mënyrën e komunikimit të saj, me lirshmërinë e saj sidomos në imitacionin e këngëtarëve. Rita krijon një sensacion, pasi prezanton gjithë programin pa letër Kjo bëri që ai koncert të karakterizohet nga një freski e ndërthurr midis tre komponentëve siç ishin: stina e pranverës, prezantimi dinjitoz dhe interpretimi mjaft virtuozi i këngëtarëve pjesëmarrës.

Në vitin 1983 në koncert i për fesat 28

- 29 Nëntor, interpretoi si soliste, ku fitoj çmimin e parë, të cilin ja dorëzoj ikona e sopranos Marie Kraja

Në vitin 1984 ka shoqëruar Maria Farandurin, këngëtare Greke në të gjithë Shqipërinë dhe kam bërë koncerte bashke me te.

Në vitin 1984 është organizuar koncerti "Karajfilat që ka Shkodra" ku ka kënduar si soliste duke u vlerësuar vendin e parë për interpretim të lartë të këngës qytetare.

Në muaj maji 1984 ka realizuar koncert lirik në "Lidhjen e Shkrimtareve e Artisteve"1984

Në 1984 me propozim të Gjergj Vlazit regjisor i estradës së Durrësit, i cili po vinte në skenë një estrade me trupën estradës profesioniste të Shkodrës mori pjesë si këngëtare, por luajti edhe si aktore estrade në rolet e aktore Jolanda Shala, e cila u largua papritmas nga jeta. Në atë premiere ka imituar në skenë bashkë me Zef Deden artistet më në zë të kohës.

Në vitin 1985 ka filluar punë si aktore profesioniste në estradën e Shkodrës si aktore humorit dhe si këngëtare.

Në Nëntor 1985 u organizua në Shkodër, konkursi i Estradave profesioniste në shkallë Republike. Shkodra u përfaqësua me premierën "Ditë buzëqeshjesh" me regjisor Edmond Mëhilli, ku ndër të tjera luajta edhe një komedi me një akt "Njeriu pa emër" siç njihet "Xhemal Katundari". Estrada jonë mori çmimin e parë, ndërsa Rita nderohet me medaljen si aktorja e re më e mirë në Shqipëri. Dhjetor 1985 incizime në RTVSH për programin e Vitit të Ri.

Atë vit pati një risi në programin e vitit të ri, pasi Zef Deda dhe Rita kane bërë një lidhje direkt nga 15 katshi, duke interpretuar live humor duke sjell gëzim në të gjitha shtëpitë shqiptare. Këtë risi u besoi Osman Mula regjisor i programit të vitit të ri

Me 10 Janar 1986 koncerti i 10 sportistëve më të mirë në pallatin e sportit në Tiranë, Rita interpretoi si vetmja femër përkrah artisteve me artistët më të mirë të artit shqiptar të kohës si Zef Deda, Aleko Prodani, Fadil Hasa, Mirush Kabashi dhe unë si e vetmja femër.

Me 20 deri me 26 Janar 1986 të ftuar në Korçe bashke me Bashkim Alibalin, Zef Deden dhe Mirush Kabashin. Shfaqjet jepeshin në pallatin e sportit të Korçës.

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 1986 ka bërë turne të suksesshme në Tiranë, Vlorë e të tjera...

Në vitin 1986 - 1990 ka mbaruar studimet në "Akademinë e Arteve" dega dramaturgjii.

Me 6 shtator 1986 koncert recital në Lukove.

Me 10 shtator 1986 koncert recital në Shën Vasil.

Me 15 shtator 1986 koncert recital në Sarandë.

Në tetor 1986 Koncert në Shkodër.

Me 24 Tetor 1986 koncert në "Pallatin e Sportit" në Tiranë.

Me 6-7 dhjetor 1986 xhirime për programin e vitit të ri.

Është aktorja e parë e humorit që zhvilluar shfaqje recital të kohës. Risetë në artin skenik ishin interpretimi me nivel të lartë profesional të roleve që merrja përsipër duke i shtuar vlera edhe

këngëtarit origjinal. Asnjëherë nuk e ka bullizuar në skenë asnjë person, apo minoritete nga prejardhja, as nga të metat fizike dhe mendore. Asnjëherë nuk kam bërë në skenë humor banal.

Kam thyer tabu për kohën duke qenë vajza e parë e re, e hijshme, e talentuar dhe në moshë të re që sfidonte mentalitetin e kohës. Liria e saj në skenë ishte një shenjë shprese para spektatorit, sepse duke parë Ritën të lirshme në skenë si askush tjetër në Shqipëri, që kërcente, këndonte dhe interpretonte e lirë, shqiptarët e ndjenin se liria nuk ishte larg.

Në Dhjetor 1987 marrë pjesë në festival, së bashku me parodistët e Vlorës, duke kënduar një parodi në duke parodizuar të gjithë festivalin.

Në vitin 1988, me 28 mars ishte prezantuese dhe drejtuese e koncertit "Kur Vjen Pranvera". Prezantimi i parë pa letër në dorë dhe e lire duke shkallmuar mënyrën e shablloneve të të prezantuarit me letër në dorë.

Në dhjetor 1988 mori pjesë me parodistët e Vlorës dhe programi i vitit të ri.

Në muajin Janar 1989 e ftuar në Korçë me Frederikun e Julin, të motrën dhe



Parashqevi Simakun. Koncerti është bërë natën e parë në teatër "Anton Zako Çajupi". Në atë koncert këndon Juli një këngë të Barbra Straisand Women in Love.

Më 1989 së bashku me Agronin zhvillojnë një koncerte si në të gjithë Shqipërinë.

Në vitin 1989 u vlerësua si aktorja më e mirë e vitit. Frederiku dhe Juli morën çmimin e parë në festival të RTVSH së bashku me Manjola Nallbanin.

Një tjetër risi, për të cilën Rita ka një meritë të veçantë, është edhe eksperimentimi i kameras së fshehtë së bashku me regjisoren Vera Grabocka. Skena të papritura të mbushura me humor e shije gazmore rrëmbyen të qeshurat e pafundme të teleshikuesve. Skena të papritura të mbushura me humor e shije gazmore



rrëmbyen të qeshurat e pafundme të teleshikuesve. Rita për shumë vite ishte gjithnjë e pranishme dhe e mirëpritur nga spektatori e teleshikuesi, për mënyrën argëtues në qindra skeçe, pantonime parodi, monologje emetime, recitime, bejta përkrah emrave më të spikatur te humorit shqiptarë. Karriera e saj mori vrapin drejt majave më të larta, ndër koncerte, mbërmeje, në programet e Vitit të Ri, Mbas festivalit të 11-të mbase është e para artiste që guxoi për të hequr mikrofonin nga stativi. Plastika, gjestikulacioni, mimika, tingëllimi e lëvizjet e shkathëta konturojnë tashmë figurën e saj prej një artisteje të vërtetë.

Në muajin Tetor 1990 konkurs i estradave profesioniste zhvilluar në Përmet. Estrada e ushtarit u paraqit me punën e diplomës dhe mori çmimin e parë.

Në muajin Tetor 1990 transferohet nga Shkodra në Tiranë, emërohet në estradën e shtetit.

Në muajin Dhjetor 1990, në festivalin e RTVSH, debutoi e ftuar për parodi dhe imitime. Si dhe përgatitjet e programit të vitit të ri 1990-1991.

Me 1990, në festivalin e fundvitit, kam marrë pjesë si e ftuar duke imituar këngëtarët. Numri im i humorit si në festival ashtu dhe në programin e vitit të ri ishte më i suksesshmi. Në lëvizjet demokratike ishte kudo me Rajmonda Bulku e Gramoz Pashko, në mbledhjet tona për PD.....

Me 1991 mori pjesë në shfaqje me estradën e ushtarit në çdo cep të Shqipërisë

Me 8 Nëntor 1991 ka dalë nga Shqipëria bashkë me teatrin popullor për një turne në të gjithë Shqipërinë.

Pas emigrimit në Gjermani ka marrë pjesë nëpër koncerte në Gjermani dhe Evropë me çdo grup që vinte nga Kosova dhe Shqipëria. Ka marrë pjesë në shumë koncerte humanitare për luftën e Kosovës. Ka qenë e ftuar në çdo aktivitet që ka organizuar ambasada e jonë në Bonn e më pas në Berlin.

Rita Ndoci ka 31 vite që jetoj në Gjermani ku është munduar me mish e shpirt të prezantoj vlerat tona kombëtare si në familjen e saj të vogël edhe në atë gjermane

Me 24 Shkurt 2001 ka qenë e ftuar në Tiranë në spektaklin "Dua më shumë Shqipërinë", me 10 figura të shquara të artit dhe shoqërisë shqiptare si Ismail Kadare, Inva Mula, Agim Krajka, Fadil Berisha e të tjerë...

Në vitin 2001 nderohet me titullin "Ambasadore e Kombit" nga ish Presidenti Rexhep Mejdani. Në muajin Korrik 2001, e ftuar nga Vera Grabocka në spektaklin "Netët e Verës".

Në muajin tetor 2002 aktivitetet tek Deutsche Welle për Shqipërinë.

Në muajin Dhjetor 2002 merr pjesë programin e vitit të ri në RTVSH

Në muajin Prilli 2004 e ftuar në Tiranë për "Netët e Klipit Shqiptar" dhe në "Kombinat Show" nga Enkel Demit në TV Klan.

Në muajin Dhjetor 2006 koncert në Jena të Gjermanisë për ditën dhe javën shqiptare që e kemi organizuar në bashkëpunim me universitetin e Jenës

Me 24 korrik 2007 e ftuar të veçantë, në ceremoninë e betimit të ish Presidentit të Shqipërisë Bamir Topi, ku Rita, Frederiku, dhe Juli kanë kënduar Himnin Kombëtar.

Në vitin 2008 e ftuar në emisionin e Rudina Magjistarit.

Në vitin 2009 e ftuar nga e diela shqiptare nga Ardit Gjobrea.

Në muajin shtator dhe tetor 2009 koncert në Berlin me motrën Juli Ndoci.

Juli ka grupin e saj me emrin "GOJAMARS" ku unë këndo si backvocal, por edhe soliste. Në këtë aktivitet që së pari është bërë në Hamburg ky grupi ka marrë çmimin e parë, duke fituar për të marrë pjesë në natën finale në Berlin, ku u vlerësuar si grupi me vokalet me të bukura.

Në vitin 2010 e ftuar në spektaklin "Këngët e Shekullit" në TV Klan.

Në muajin Shkurt 2011 e ftuar në TV Klan për të kënduar në spektaklin "Këngët e Shekullit".

Në muajin Dhjetor 2011 pjesëmarrëse e konkurrente në festivalin e RTSH me këngën "Jeta ime" në trio me Frederikun dhe Julin.

Në muajin Dhjetor 2011 koncert në Kosovë e ftuar në RTK tek emisioni "Oksigjen".

Në muajin Dhjetor 2011 xhirime për programin e vitit të ri. Janar 2012 e ftuar në Pejë së bashku me Frederikun për spektaklin e 1 Janarit.

Në muajin Gusht 2013 koncert në Shkodër.

Në muajin Dhjetor 2014 e ftuar në emisionin "Kontrata" nga Sonila Meco.

Në muajin Gusht të 2018 koncert në Shkodër.

Me 9 dhjetor 2019 është vlerësuar me titullin "Ambasadore e Paqes" në Diaspore në Stuttgart të Gjermanisë.

Me 23 Dhjetor 2019 janë vlerësuar nga Bashkia e Vjenës Frederiku, Juli edhe Rita

Me 27 mars 2019 10 e ftuar në Shqipëri për spektaklin e Jonida Shehut Soiree ku ishin të ftuara Rita Juli dhe miqtë.

Në muajin Tetor të vitit 2019 Juli Tetor 2019 së bashku me motrën time Juli morrin pjesë në festivalin e këngës qytetare në Shkodër "Lule Bore" dhe janë paraqitur me këngën "Malli për Rranjet", e kompozuar nga Lekë Jakova dhe me tekst të Ormira Omarit vlerësuar me çmimin e 3 -të.

Në Gjermani punon si përkthyes e licencuar për gjuhën gjermane. Shqiptarët e njohin dhe gëzohen kur më kanë pranë në cilësinë e përkthyeses. Në vendin ku ajo jeton, është vlerësuar edhe si biznes-women e suksesshme.

Ka realizuar shume koncerte në Toronto - Kanada, New York - USA, në të gjithë Evropën dhe ka qenë e suksesshme dhe e mirëpritur nga spektatori shqipfolës. --

**Prele Milani, Roza Pjetri,  
Lazer Kodra e Kole Ndrevasaj**

# HAPJA E SEZONIT TURISTIK DHE FESTË NË THETH

*“O udhëtare që shkon në Shkodër mos ndalo aty. Ngjitu më lart dhe vetëm atëhere do ta kuptosh se kush është Shkodra” - Idro Montaneli*

Emri Theth tingëllon si sinonim i bukurisë. Duhet vënë në dukje se akoma Thethi nuk është eksploruar sa duhet, prandaj çdo aktivitet kushtuar kësaj perle ka vlera njohje edhe për pjesën tjetër të Dukagjinit, ende më shumë për ta promovuar. Veprimtaria e organizuar me datën 2 Korrik nga Bashkia Shkodër, duhet vlerësuar në shumë komponentë, në këtë mbarëvajtje ka meritën e saj të drejtimit krahas personave të tjerë, edhe znj. Aurora Piroviq.

Përpara teatrit “Migjeni” bëhet nisja e organizuar me automjete, por falë “korrektësisë” në masë që na karakterizon, pasi kjo nisje bëhet me afro një orë vonesë. Ndërsa grupi çiklistik “Shkodra mountain bike” vijon rrugën e vet të pavarur në drejtim të Thethit. Furgoni, me të cilin udhëtonim ishte në dispozicion të shoqatës sonë atdhetare “Dukagjini” të kryesuar nga kryetari i saj z. Ndue Sanaj, si dhe një grup këngëtarësh dhe instrumentistësh. Pas një udhëtimi të këndshëm, ndalesën e parë e bëmë në Fushën e Okolit në një lokal luksoz, ku arkitektura dhe harmonia e kësaj godine me ambientin përreth është magjepsë. Bukuria e gjelbërimit me lulet e malit me shëmbëllimin e aromës së maleve të pyllëzuara, me ahun shekullor si dhe bardhësinë vende-vende të borës, të pashkrirë në lartësinë e maleve, për ata që shkojnë për herë të parë, është shumë mbresëlënëse.

## ENIGMA E VORRIT TË T'RIESHIT

Që i vogël kisha dëgjuar të flitet për këtë varr si pikë referimi në qafën e t'Thores, që i bie rreth 1550 metër mbi nivelin e detit, që i bie përpara memorialit të mikeshës së Dukagjinit znj. Edith Durham. Po Një fjalë e moçme thotë: “Shpeshherë rastësia bën mrekullinë!”. Sapo zbritëm nga furgoni përpara objektit Bar-Restorant, në Okol të Bogës, unë duke qenë pasionant i fotografisë nuk mund të rrija pa shkrepu aparatit në këtë natyrë me bukuri të rrallë. Sapo hy në barin e lokalit kërkoj një karrige për t'iu bashkuar grupit. Dy vajza ulur aty pranë më thanë:

“Mund të uleni në tavolinën tonë meqenëse u bëmë komshinj.” Më pëlqej shprehja me humor dhe u ula pranë tyre. Njëra nga vajzat quhej Merita Gjekaj, me profesion Sociologe; ndërsa shoqja e saj e ngushtë Maria Dushaj, me profesion Ekonomiste, që të dyja nga Muzheku i t'Rieshit. Ato më tregojnë se qëllimi i ardhjes së tyre nuk ishte veprimtaria, që do të zhvillohej në Theth, por një vizitë përkujtimore, tek një objekt në qafën e t'Thores. Unë e ndërpreva duke i thënë: -Tek memoriali i Edith Durham?- ajo më

përgjigjet-, Diku aty afër saj.

Unë e pyeta menjëherë, nëse keni lidhje me varrin e t'Rieshit, duke marrë përgjigjen e prere. Po... Unë i përgëzoza për ndjesinë dhe anën njerëzore, respektin për brezat, sepse kjo traditë sot thuhet është venitur, duke të kujtuar atë shprehjen: “Na ishte një herë!” Ju bëra me dije bashkëbisedueseve, sepse më dolët në shteg dhe sot po me zgjidhi një enigmë, që e kisha të konservuar prej më shumë se një gjysmë shekulli. Në të njëjtën kohë më shkante në mendje përputhja me shpjegi-

Marija, Katrina, Gjystja dhe Tonja, duke shtuar se Nika ishte i fejuar në këto anë. Më bëri përshtypje se gjyshi i Nikë Lulë Gjekës, Toma kishte mbaruar studimet për inxhinieri ndërtimi, gjë e cila tregon për një emancipim të hershëm të kësaj familje. Ne u ndamë me premtimin e Meritës se, vijimin e bisedës do ta bënim me babën e saj, -aq më mirë-, më thotë ajo se ju lidh profesioni i mjekut.

## DUKAGJINI I HARRUAR ME BUKURI TË RRALLA



met që më jepte studiuesi dhe shkrimtari z. Luigj Shyti, lidhur me këtë varr. Merita vazhdon të më tregojë se varri i përkiste Nikë Lulë Gjekës nga Muzheku i Trieshit, që i bie të ishte baba i gjyshit të saj. Ajo në rrëfimin e saj më tregon se Nika kishte një vëlla, Gjeton; ndërsa motrat e tij ishin

Tek po zbrisim kthesat mbi lagjen Gjeçaj drejt qendrës së Thethit, në këtë rrugë të re të shumëpërfolur, e cila lëngonte që përpara se të përfundonte, mendja më shkante tek rrugët dhe tunelet qindra milionëshe në jugun e Shqipërisë, të cilat lidhin vetëm disa qytete apo zona të

veçanta me njëra-tjetrën. Ndërsa në veri-un tonë të varfër dhe të harruar ose më konkretisht Dukagjinit është e vështirë ta përshkohet me autoblanda rrugën kryesore të ndërtuar në kohën e kooperativizmit. Prej më se 30 vjetëve është folur, përfolur dhe premtuar për ndërtimin e rrugës Prekal- Breglumi, por ajo ka mbetur në harresë si ëndrra në beze. Vetëm ndërtimi i këtij aksi do të bënte të aksesueshëm jo vetëm Thethin, por të gjithë Dukagjinit gjatë gjithë vitit. Në fshatra të ndryshme të Dukagjinit, sot mungon edhe energjia elektrike, për rrjedhojë mbetet pa energji që prej fillimit të veprimtarisë pika turistike “Lumi i Shalës” tashmë e njohur botërisht. Në rast se në jug një kilometër rrugë apo tunel kushton qindra miliona euro, superstrada Tiranë-Shkodër, e cila lidhe Shqipërinë me perëndimin, me një gjatësi me pak se 100 km, ta përshkohet këtë segment duhen afro dy orë, ndërkohe që kjo rrugë lidh Shqipërinë me Evropën.

## THETHIT DHE DUKAGJINIT BUKURITE JA KA FALE ZOTI, POR MENDJA DHE DORA E NJERIUT ÇFARË DUHET TË BËJNË?

Tek po përshkonim Thethin po hamendësonim për vendin e organizimit të veprimtarisë, duke menduar për lëndinën e ish kampit të punëtorëve, logun e Kishës së Thethit apo pranë Kullës Muze. Si për ironi na del përpara papritur tenda dhe podiumi, që ishin ngritur në një zall ishte pranë shkollës, në mes të rrugës, ku automjetet bllokoni njëra tjetrën. Duhej të ndërhynte policia bashkiake për të vendosur rregull. Menjëherë më shkoi në mendje një punëtor policie, me emrin Ndoc Pjetri në vitet 1960-1970, me një gjatësi trupore nën mesatar, i cili gjithë ditën tregonte barcaleta, sepse në të gjithë Dukagjinit problemet me rendin ishin tepër të rralla.

Në kundërshtim të plotë me traditën shumëshekullore të këtyre anëve, tërveza e pritjes ishte shtruar në rrugë të madhe, duke anashkaluar disa pika strategjike shumë të përshtatshme. Thethi të magjeps në stinën e Verës po se po, por edhe në stinën e Dimrit dhe në çdo stinë të vitit Zoti ka treguar gjithë bujarinë e tij, duke i dhuruar gjithçka kësaj natyre, por bujarinë dhe mikpritjen edhe në kohët më të vështira. Kur njerëzit e dëshpëruar kërkonin të kalonin kufirin nëpërmes ty-tave të pushkëve, disa familje thethjane bujare i prisnin dhe i përcillnin duke rrezikuar jo vetëm familjen por edhe farefisin. Gjithashtu humanizmi i tyre ka spikatur edhe në shpëtimin e shumë jetëve të alpinistëve dhe të turistëve vendas dhe të huaj, nder dekada.

Çdokush sot flet për binomin Valbonë-Theth-Lumi i Shalës, të cilat së bashku përbejnë bukurinë e Alpeve. Një personalitet i shquar botëror David Smith drejtor i USAID-it, teksa shoqërohej në Theth nga profesorët Ahmet Osja dhe Zef Gjeta vite më parë, këta tregojnë se ai nuk fjeti gjatë gjithë natës në shtëpinë thethjane, duke pritur me padurim për të parë mrekullitë e natyrës. Por befasia më e madhe ishte kur prof. Ahmeti i beri një eksperiment të thjeshtë në një lëndinë. Mbi barin e njomë, profesori vendos këmbën për disa çaste duke asfiksuar në njëfarë mënyre barin dhe më pas i numëron mikut 17 lloje barishtesh e lulësh nën atë sipërfaqe këpuce. Ai u surprizua jo vetëm nga praktikiteti i profesorit, por dhe u shpreh se: - “Kjo nuk mund të ndodhë në asnjë vend tjetër të botes, dhe se këtu qenka tokë e bekuar”.

**THETHI PA JETË KULTURORE**

Zhvillimi i disa koncerteve të muzikës POP dhe ROCK-ROLL dhe rrymave të tjera zhvilluar dy-tre vitet e fundit në Theth ngjallën mjaft interes, por me shikues më shumë të ardhur sesa vendas. Kjo traditë jo mikpritje u përsërit edhe me datën 2 Korrik. Në hapje të sezonit, ku në shesh nuk ishin të pranishëm as nga grupi i bujtinave, dhe jo më vendas të larguar nga Thethi, të cilët numëroheshin me gishtat e dorës. Për të mirëpritur të ardhurit nga këto biznese ose për të ofruar diçka sado simbolike as që nuk e mori kush mundimin. Tradita vendase nuk duhet harruar, por duhet motivuar. Dikur familjet thethjane prisnin e përcjellin miq edhe kur fëmijët e tyre flinin pa darkë. Sot situata është krejt ndryshe. Askush nuk vjen këtu për lëmoshë, por bujaria urohet me shprehjen tipike malësore “Ta shtoftë Zoti”, kjo ka kuptimin e vet. Ka një rregull të pashkruar që thuhet, që të fitosh duhet të dish dhe të tregohesh bujar, edhe për të ruajtur traditën shekullore të familjeve malësore. Sot bujtinat janë komode dhe plot, ku nuk mungon asgjë. Një shprehje e vjetër thotë “Nderën e bën në det dhe të vjen në kripë”. Secila nga bujtinat në këtë ditë promovimi mund të sillte diçka modeste për këta të ardhur, të cilët kishin lënë angazhimet e përditshme për të festuar me të zotët e shtëpisë. Ndërsa pjesa e organizuar kishte të siguruar vetëm transportin nga ana e bashkisë. Mësuesi veteran z. Zef Bari, kryetar i degës së shoqatës atdhetare “Dukagjini” në Tiranë, paraqiti mangësinë e organizimit dhe mospjesëmarrjen e pafalshme të vendasve, duke iu kërkuar ndjesë të pranishmeve. Ende më keq kur miqtë e ardhur, personalitete të nderuar në fushat e tyre flisnin me superlativa për Dukagjinin, të cilët kishin shërbyer këtu në vite të rinisë së tyre, ju ndërhyej në oratorinë e tyre, duke treguar mungesë etike dhe burrërie. Miku duhet respektuar e aq më tepër kur vjen për të të nderuar dhe respektuar. Jeta kulturore përgjatë sezonit turistik mbetet amorfe, në vend që të gumëzhije muzika dhe veprimtaritë e tjera, këtu ka heshtje. A do të ishte me vend, që këta pronarë të lënë mbrapa meritë që shkakton konkurrenca dhe të bien në godi për të mirën e tyre, për të gjallëruar jetën e përditshme, gjë e cila do të shtonte edhe të ardhurat?! Në skajin tjetër të Du-



kagjinit tek “Lumi i Shalës” ndonëse në kushte ekstremisht të vështira, duke filluar nga rruga e amortizuar e Komanit, pa energji elektrike dhe ujë të pijshëm, megjithatë jeta artistike është më e gjallë dhe e larmishme. Pronarët e bujtinave së bashku, ose në mënyrë individuale ftojnë grupe dhe këngëtarë të njohur nga treva të ndryshme dhe vendas, dhe së bashku me turistët festojnë sidomos në mbrëmje, si një familje e madhe duke organizuar lojëra popullore, duke kënduar me instrumente popullore, çifteli, fyell dhe lahute. Pa jetë kulturore dhe zbavitje qëndrimi i turistëve bëhet monoton dhe i shkurtër në kohë. Në qoftë se në Theth do të kishte gjallëri, atëherë poshtë urës së Grunasit, në atë lëndinë, nuk do ta kalonin natën në qiell të hapur me qindra pushues me automjetet e tyre të ardhur nga vende të ndryshme.

Thethi në shekuj ka nxjerrë intelektual dhe njerëz të spikatur, por a do të ishte e udhës që në raste të veçanta t’iu rrëfehej turistëve dhe brezit të ri diçka për personalitetet kombëtare nga Thethi siç janë, at Daniel Gjeçaj, Ambroz Martini, Gjergj Pëllumbi apo Ndue Vatë Gjela, ose të përjetësohen së paku me një pllakate në qendër të Thethit. Një gjë e tillë mund të evidentohet edhe për disa të huaj, të cilët kanë kontribuar dhe kane shkruar, duke u shprehur me superlativa për këtë popull dhe këtë vend, si: të ndërtohet një muze për albanologun Rober Elesie, i cili me amanetin e tij u varros në Theth. Ishte në kohën dhe momentin e duhur që të ftoheshin një grup piktorësh së paku nga shkolla artistike “Prenke Jakova”, për të hedhur në telajo natyrën dhe veprimtaritë e organizuar, me penelin e tyre.

**ÇFARË NUK SHKON NË THETH?**

Si dashamirës i Thethit nuk marr përsipër rolin e kritikut apo të specialistit të fushës që të shprehem për disa vërejtje në fushën e ndërtimit dhe të restaurimit. Thjesht me eksperiencën time të përgatitjes autodidakte në këtë fushë mund të pronocohej. Në Theth pavarësisht pengesave burokratike dhe mos angazhimit të qeverisë, ritmi i ndërtimeve dhe sidomos i restaurimeve ka pësuar një progres të dukshëm, por a është në logjikën e ndërtimit, që në Theth si vend alpin turistik, muret shekullore të kullave të gurit nga brenda të vishen në gips, apo dhomat të ndriçohen nga llambat e neonit. Është në kufijtë e palogjikës që shkallët e drurit të zëvendësohen me beton arme.

Gjithashtu është paradoksale që çatitë e mbuluara me dërrasë pishe të zëvendësohen me llamarine apo sanduiç. Kur u ndërtoa Kisha e Thethit a mund të imagjinohej tjetër çati veçse ajo me dërrasë? Po kur u bë së fundmi restaurimi pse mbeti përsëri me dërrasë? Në të kundërt do të ishte sikur ti vesh shalën atij që nuk i shkon. Turisti Nordik, Gjerman, Çek apo vendas nuk vjen në Theth për të joshur këto ndërtime apo restaurime të përcudnuara dhe as nuk vjen për të shijuar vajin e palmës, pulat holandezë, mishin brazilian dhe as haxhimakullet. Ai shijon objektet dhe ushqimet autoktone, si mazën aq të preferuar për Edith Durham dhe Rose Lain, prodhimet blegtorale, lene pastaj qumështin me borë mali.

**CEREMONIA E PROMOVIMIT DHE KONCERTI**

Në këtë veprimtari të çeljes së sezonit turistik morën pjesë të ftuar, nga pushteti lokal dhe ai qendror, si: z. Bardh Spahija- Kryebashkiaku i Shkodrës, znj. Greta Bardeli- deputete, z. Ndue Sanaj- kryetar i shoqatës atdhetare “Dukagjini”, z. Petrit Arra- kryetar i njësisë administrative të Shalës, z. Agim Dardha- drejtor i administratës së zonave të mbrojtura, znj. Besara Podgorica- drejtoreshë rajonale e trashëgimisë kulturore, znj.-Amila Gjyzezi- drejtoreshë e muzeut të Shkodrës, z. Helidon Sokoli -drejtor i Kështjellës “Rozafa”, z. Zamir Tafilica- historian e arkeolog, z. Muhamet Shala- ish-drejtor i shkollës Breglumit, z. Zef Bari - mësues veteran në Theth, z. Marash Rrgalla - Kryeplaku i Thethit. Gjithashtu nga artizanët merrnin pjesë: znj. File Strugaçi, znj. Rita Shkurtaj-Kryetare e shoqatës kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare”, znj. Jetmira Kajoshi “Natyra ime”, me një larmi bimësh mjekësore dhe eterovajore. Nga grupet artistike ishin të ftuar: Grupi folklorik “Treva”, Shoqata kulturore “Besa –Shoshi”. Këngëtarët: Viola Shqau, Gofile Papeka, Sokol Gjoni, Kole Hasani, Gentian Gropa, Bledar Hysenaj e të tjerë. Lahutarët: Lulash Gjergji e Pretash Nilaj, violinistë Duliem Puka, recituese Hea Lohja, Grupi çiklistik “Shkodra mountain bike”.

Me panairin e ushqimit u prezantuan bujtina “Gjeçaj” dhe “Pepaj”. Gjithashtu u prezantua edhe ekspozita fotografike e jetës së egër nga fotot e shoqatës “Wild Arbëria”. Ishin të pranishëm edhe natyralistë dhe ambientalistë të ndryshëm. Numri i pjesëmarrësve të ardhur nga Shkodra në mënyrë të organizuar ishte 145 pjesëmarrës. Ndërsa pjesa tjetër kishte ardhur në mënyrë individuale. Drejtues dhe organizator i spektaklit z. Astrit Fani, moderator Jursi Temali dhe Ezdra Isufi.

Përsëritja e të pranishmëve u bë nga z. Bardh Spahija, i cili u shpreh se për Dukagjinin kam një nostalgji të veçantë të trashëguar nga paraardhësit e tij. Ky paraqiti vlerat, traditat, bujarinë, besnikërinë, të cilat dukagjinasi i ka në gen. Por theksoj se pushteti lokal dhe ai qendror jemi debitorë përpara zonës së Dukagjinit. Mosdhënia e titujve të pronësisë shumëshekullore është e pakuptimtë dhe një zvarritje burokratike, gjë e cila pen-



gon zhvillimin e zonës. Prandaj premtoi ai, do të luftoj me të gjitha forcat që këto burokracira të mos bëhen pengesë për zhvillimin e mëtejshëm, duke punuar fort për të rritur investimet në infrastrukturë.

Përsëritja e rrallës u bë nga znj. Greta Bardeli. Si bijë e Shalës, ajo uroj mirëseardhjen e të pranishmëve. Kontributi i jashtëzakonshëm i gruas dukagjinase u shpreh ajo:- ka vlera të mëdha historike. Ajo është një grua e fortë, e cila edukon fëmijë te devotshëm, mban burrin dhe familjen në kushte të një natyre të

ashpër.

Personalitetet e Dukagjinit në të gjitha kohërat i lindi dhe i rriti gruaja e këtyre maleve. Do të bëjmë çdo përpjekje, shtoi ajo duke ngritur zërin në parlament dhe në qeveri për të investuar në këtë zonë për të krijuar kushte që të ecet me rritmë më të shpejta zhvillimi.

Në fjalën e tij z. Ndue Sanaj- kryetar i shoqatës atdhetare “Dukagjini” bëri një analizë të qenësishme për Dukagjinin, duke nxjerrë në pah shumë vlera të kësaj zone, me statusin e hulumtuesit dhe botuesit të disa librave, për Dukagjinin.

Përsëritja z. Agim Dardha, si drejtor i zonave të mbrojtura evidentoi punën e palodhur sidomos në vitet e fundit. Ai theksoi se sipërfaqja e mbrojtur ishte 2640 hektarë, ndërsa sot kjo është rritur në 84000 hektarë, ndërsa Shala ka 11700 hektarë. Ai foli gjithashtu edhe për fondet për të rritur efikasitetin e këtyre zonave të mbrojtura.

Profesor Muhamet Shala, ish drejtor i shkollës Breglumit u ndal kryesisht në traditën e veçantë të zo-


nës. Ai erdhi këtu plot 59 vjet më parë. Në saje të një kujtese fenomenale përmendte punonjës të administratës prindër dhe nxënës emër për emër sikur i lexonte nga një ditar i posaçëm.

Përsëritja z. Zamir Tafilica, historian dhe arkeolog foli për zbulimet dhe studimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si dhe punën disa vjeçare me disa studiuues amerikan nga Kalifornia te botuar në librin “Dritë dhe Hije”, por fatkeqësisht i pa përkthyer në gjuhën Shqipe. Ky libër studimor përmbledh jo vetëm arkeologjinë e zonës por gama e studimit të tij është shumë e gjerë dhe hulumtuese deri në detaje, për Dukagjinin.

Kryeplaku i Thethit z. Marash Rrgalla pasi përsëritja pjesëmarrësit, i kërkoi drejtuesve të bashkisë që të tregojnë kujdes për të investuar në këtë zonë, dhe uroj që këto veprimtari të kenë vijimësi. Studiuesja Rita Shkurtaj, shprehi zemërimin se xhubleta po humb çdo ditë origjinalitetin e saj. Kostumi karakteristik i burrave, - shtoi ajo-, ka degraduar dhe është shpërfytyruar, duke mos ruajtur asgjë nga ai tradicional. Edhe sot veshjet e pjesëmarrësve ishin disa imitime të pavlera, të cilat nuk kanë të bëjnë me veshjen origjinale malësore, por një modifikim i shëmtuar i saj-, shtoi ajo.

Veprimtaria vijoi edhe dy ditët në vijim, me marshime në vende të veçanta, gara çiklistikë dhe vizita në objekte dhe në monumente kulture. Hapja e këtij sezoni turistik sapo përfundoi duke treguar vlerat dhe mangësitë e konstatuara. Sapo marrim rrugën e kthimit, bashkëshoqëruar na behet një i shumëpritur. Në qiellin pothuaj pa re fillon një shi shume i dendur i cili na vështirosi edhe rrugën duke na përcjellë deri sa i ‘u afruam Fushës së Okolit, por për çudinë e të gjithëve ky shi nuk kishte ra askund tjetër. Menjëherë mendja më shkoi tek David Smith, drejtor i USAID-it kur shprehej se: “..... këtu qenka tokë e bekuar”. Dëshirojmë dhe shpresojmë se vitet në vijim do të kemi promovime dhe pjesëmarrje më të zgjeruar dhe të shoqëruara me një larmi veprimtarish!

**Mark Bobnaj, studiues**  
Theth, më 2 Korrik 2022.



# Paraqitja e disa vlerave, në festën e Thethit

Të nderuar pjesëmarrës në Festën e Thethit!

I nderuar zoti Bardh Spahija, kryetari i bashkisë së Shkodrës!

E nderuara zonja Gerta Bardeli, deputete e Kuvendit të Shqipërisë!

Të nderuar banorë të Thethit, të kryeqendrës së Alpeve Shqiptare!

Zonja e zotërinj!

Kam privilegjin, që në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe në emrin tim personal t'iu përshëndes dhe t'ju them: "Mirë se ju gjetëm!"

Ndodhemi 740 m mbi nivelin e detit ...

Pak histori për Thethin:

Thethi del për here të pare në dokumente rreth vitit 1485 dhe quhej "Fusha", dhe emrin Theth e përmend për here të pare Coronelli, në vitin 1688.

Në Theth, sipas toponimeve dhe burimeve historike kane jetuar fiset Oksetet, Bythdosët (Bitidoset, Budadoset) dhe Barbatet.

Në vitin 1892 ndërtohet kjo kishë që është në funksion edhe sot.

Në vitin 1917 hapet shkolla nga At' Shtjefen Gjeçovi, për të mësuar shkrim e këndim në shqip fëmijët e malësoreve. Në vitin 1921 nga Pader Marjan Prela u rihap shkolla me ndihmën e Kryqit të Kuq Amerikan. Me 27 prill 1936 hapet shkolla shtetërore dhe mësuesi i pare ka qene Karlo Ljarja.

Në vitin 1935 vjen në qendër të fshatit rruga e automobilistike.

Thethi dhe këto Alpe janë vizituar shumë herë. Ngjitja e pare në Majën e Jezercës, e regjistruar është bërë para vitit 1827, nga djem thethjanë të udhëhequr nga një prift austriak.

Në vitin 1937 është ngritur në Theth një ndërtesë shtetërore për sportet malore.

Maja më e larte, maja e Jezercës në Alpet Dinarike, e dyta më e lartë në Shqipëri dhe e gjashta më e larta në Ballkan, me lartësi 2 694 m mbi nivelin e detit. Është maja e 28-të më e spikatur malore në Evropë dhe vlerësohet si një nga ngjitjet më të vështira dhe më të rrezikshme në Alpet Shqiptare. Ngjitja e parë në këtë maje, është bërë me 26 korrik 1929 nga persona të huaj: Ellëood, Elmalie dhe Sleeman

Në vitin 1887, ishin nxënësit e kolegjit françeskane, të cilët veruan në mënyrë të

organizuar për here të parë në Theth.

Në vitin 1956 çelet zyrtarisht shtëpia e pushimit në qendër të fshatit, në shtëpinë e Pashko Ukshinit dhe në vitin 1965 ndërtohet hoteli aty ku është dhe sot.

Në fundin e viteve '80, rreth 1000 per-

un e Dhënve.

Me vendim të Këshillit të Komunës së Shalës, në maj 2001, Thethit i jepet titulli "Parku i Paqes"

- Në Theth janë bërë gërmime nga arkeologe vendas e amerikanë, të cilat



sona kalonin pushimet çdo Verë në Theth, prej të cilëve 400 prej tyre në familjet thethjane.

Në territorin e Thethit gjenden rreth 50 përqind e llojeve të bimësisë të Shqipërisë. Të veçanta: -Llapoi i Dorflerit. -Zambaku Shqiptar, i radhë. - Bima e birrës, shumë e radhë (humulus lupulus), e cila rritet në gjendje natyrale afer muzeut në fushë të Thethit. -Vjollca e Dukagjinit e radhë e të tjera e të tjera. Në Theth gjenden rreth 200 lloje bimësh mjekësore, të ngrënishme dhe ngjyruese, që të gjitha në gjendje të egër.

Me vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 96, date 21 nëntor 1966, Thethi shpallet "Park Kombëtar"

Me vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 676 datë 20 dhjetor 2002, në këtë park u shpallen monumente natyrore: Ujëvara e Thethit-Grunas, Shpella e Thethit (Bira e Rrathëve), Cirku i Gropës së Jezercës, Liqeni i Jezercës, Burimet e Okolit, Pisha Flamur në qafen e Pejës, Shpella e Majës së Harapit, Kështjella natyrore në Shteg-

vërtetojnë banimin e hershem të këtij territori në kapërcyellin e kohës së bronzit dhe të hekurit.

Pra, për historinë dhe vlerat e kësaj kryeqendër të Alpeve Shqiptare, ka shumë për të thënë, por u ndala në disa prej tyre që mendojmë se nxitin turistët dhe turizmin në këtë fshat dhe rrotull tij.

- Ne mendojmë se turizmi duhet të zhvillohet në të gjithë Dukagjinin, duke pasur si shembull Thethin. Dukagjini, me pesë krahina apo Njësi Administrative, si Shala, Shoshi, Pulti, Temali e Shllaku, me 40 fshatra, ka vlera unike në të gjithë territorin e tij. Në fushën e historisë, që janë disa objekte historike, ndoshta dhe mbi 2000 vjeçare, si kështjella e Dakajve në fshatin Gimaj, objekti në Boks të fshatit Gjuraj, në malin e Mgullës, në lagjen Leqjonaj të fshatit Kir, në fshatin Gegaj të krahinës së Shllakut, të cilat ende nuk janë pare nga arkeologët sa dhe si duhet.

- Ngjarjet madhore në luftë me çdo pushtues, si në qafë të Agrit, Përbadhja e Madhe e Planit, Lufta në Gurin të Kuq e

të tjera e të tjera, pa hyrë në zbrërthimin e këtyre momenteve për arsye kohe.

- Gjithashtu ka etnografi, bukuri e vlera natyrore, ndërtim banesash e urash. ka folklor popullor origjinal, ka gjë a gjëza, ka pasuri kafshë të egra të shumëllojta, ka bimësi të pasur, madje disa që nuk gjenden në asnjë vend tjetër të botës, si -Vulfenia e Baldaçit që gjendet poshtë Shtegut të Dhënve.

Në Dukagjin është e mundur që të zhvillohet turizmi gjithëvjetor dhe në gjitha hapësirat e fushat e turizmit në zonën e Dukagjinit, ashtu si është punuar e po punohet në çdo kohë në Grykëderdhjen e lumit të Shalës, në liqenin e Komanit, në vendin e pagëzuar me emrin "Blini i Gurit të Lekës", që nga viti 2014, në krahinën apo Njësinë Administrative të Shoshit, të vijohet puna dhe në Njësitë e tjera Administrative, duke filluar në Fushë të Cukalit, nga Njësia administrative e Shllakut.

Për të zhvilluar turizmin në Dukagjin duhet të zgjidhë qesen pushteti vendor dhe ai qendror, por administrata e Njësiave vendore duhet të jete më e përgjegjshme, më kërkues, më aktive. Është e domosdoshme të lidhet rruga e asfaltuar Theth-Prekal. Por, nuk duhet të pritët që të përfundojë rruga, duhet të fillojë puna për të hapur e shënuar shtigje, të reja për ecjet malore, të fillohet e të përshtaten bujtinat ekzistuese, të përgatiten guita, (udhërrëfyes), për të ndihmuar turistët në udhëtimin e tyre, të kërkohen dhe të jepen mbështetje me fonde për të investuar për zhvillimin e turizmit.

Ne duam dhe kërkojmë që turizmi në Dukagjin të zhvillohet i gjithanshëm, duke rritur, në radhë të parë më shumë përgjegjësinë tonë dhe duke qenë më këmbëngulës dhe bashkëpunues me strukturat shtetërore, për të kryer më me përgjegjësi se deri më sot detyrën, për të na ndihmuar në gjithanshmërinë e jetës së përditshme të kësaj zonë me vlera të veçanta dhe të shumta.

Gëzuar festën e Thethit!

Ju faleminderit, për kohën që më kushtuat!

**Ndue Sanaj,**

Theth, 2 korrik 2022

## Prelë Tuli i Salcës

Me rastin e 100 vjetorit të Pavarsisë së Shqipërisë risjellim të ribotuar librin "Prelë Tuli i Salcës".

Ky libër është shkruar nga Pal Dukagjini (At' Daniel Gjeçaj), i cili një pjesë të jetës e kaloi në zonën e Dukagjinit, gjë e cila i dha mundësin ta njihnte më mirë, mitologjinë, folklorin, historinë e shkrueme dhe të pashkrueme të skajevë veriore të Shqipërisë.

Ky libër u ribotua nga Qendra e Katolikëve Shqiptarë, me qendër jashtë Atdheut, në Romë në vitin 1988.

Ky është një tjetër kontribut i Fran-


çeskanëve shqiptarë për historinë dhe letërsinë e kombëtare.

Fra Gazmend Tinaj, Minister Privincial

PRELE TULI

Por kam pa trima e s'kam pa,  
Si atë Prelë Tulin, por s'kam pa,  
Qi Merturit paka pri,  
N' dy calina e m'nji harbi,  
Hutën n'krah, zjarmin n gji.  
**Lahuta kangë XVII, 571- 75**

"Pranëvera e 1910-tës duel rrye-



shëm. Shën Gjergji, që ndër malet tona bjen me vedigjeth e bar, atë vjetë zbukuroi vetëm ndonji «bajrak» ndër pyje e aty-këtu ndonji stomb a livadh në shulla, të mprojtun prej verit. Bora vonoi me u de e deri në vërrin arat e ograjat në kapt laracoheshin po, por s'dijshin kurr me ja lëshue rendin barit e parmendës. Të mjellunat u shtynë. Vetëm ndonji ship më të rrallë muji të xajë qetë, sin der vjet tjera, ke kulla në breg të lumit apo më ndonji zagën në lugina të ulta dhe të mshehta. Mbas cegmës e borës kapën shinat që s'dijshin me da. Shumëkujë që hajnisht motit, qiti të lashtat,..."

**Sokol Dedëndreaj**



# Pulti kujton dhe promovon, festa e “Qereshit-2022”

Vijon tradita e veprimtarisë “FESTA E QERESHIT”, traditë kjo e rrënjësuar dhe mbeshetur në vite nga banorët e zonës, Bashkia Shkodër dhe së fundmi GIZ Albania.

Më datë 15 korrik 2022, është organizuar “Festa e Qereshit”, përkujtimi i luftës së popullit të Planit, 107 vjet më parë kundër pushtuesit serbo-malazez, program artistik, promovimi i resurseve të zonës dhe eksplorimi i bukurive natyrore, panairi i produkteve ushqimore të traditës, ishin elementet që pasuruan këtë veprimtari.

Në fjalën e hapjes, z. Tom Marku administrator i njësisë Pult, përshëndeti të pranishmit duke theksuar rëndësinë e promovimit të Pultit, produkteve, natyrës e të gjithë historisë së lavdishme të kësaj krahine.

Veprimtaria u përshëndet nga z. Tonin Dedaj, nënkryetari i Bashkisë Shkodër, i cili shprehi vlerësimet dhe nderimet e tij për Dëshmorët e Planit dhe qëndresën heroike të popullit të Planit, për mbrojtjen e vatanit. Gjithashtu shprehi vlerësime për mikpritjen, traditat dhe mrekullitë natyrore të krahinës së Pultit.

E pranishme në këtë veprimtari ishte dhe përfaqësuesja e GIZ Albania znj. Adela Llatja, e cila përshëndeti veprimtarinë dhe shprehi qartazi rëndësinë e promovimit të vlerave dhe resurseve natyrore të të gjithë malësive të Shqipërisë e konkretisht Njësisë Administrative Pult. Ajo foli mbi mbështetjen që GIZ vazhdon të japë për zhvillimin e zonave rurale, që në mes të tjerave theksoi: “Zgjidhëm pikërisht Gjurajt e Planit, aty ku ngrihet lapidari i Dëshmorëve të Planit dhe Dukagjint, rënë në luftë me pushtuesit malazez në vitin 1915 ...”.

Përfaqësues të Bashkisë së Shkodrës, familjarë të dëshmorëve e përfaqësues të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” vendosën kurora me lule dhe bënë homazhe për ata burra e gra, që dhanë jetën dhe që sot pas 107 viteve na bëjnë të ndjehemi krenar.

Takimi dhe kuvendimi me banorët e Pultit, është një kënaqësi e veçantë. Ato janë të drejtpërdrejtë, flasin hapur dhe me një mençuri, që duket se buron natyrshëm, ashtu si uji i ftohtë i lumit të Kirit që përshkon të gjithë zonën.

Ajo që bie në sy nga kjo veprimtari, është mungesa e totale e shtetit për mbështetje të malësive të Dukagjinit. Mungesa të theksuara në shërbimet bazike të tilla si infrastrukturë rrugore, shkolla, qendra shëndetësore e të tjera, mungesa këto që kanë bërë të domosdoshme largimin dhe braktisjen e Pultit.

Falënderojmë pa masë çdo pjesëmarrës në këtë veprimtari, falënderojmë grupin organizator të festës së Qereshit, Bashkinë Shkodër, Giz Albania, falënderojmë vëllezërit, Sukaj nga fshati Gjuraj, vëllezërit Gjinaj nga fshati Mguillë dhe



vëllezërit Rrushaj nga fshati Plan, për mbështetjen financiare dhe në çdo drejtim të kësaj ngjarje kaq të rëndësishme për krahinën e Pultit. Gjithashtu falënderojmë çdo aktor tjetër ndër vite që ka bërë të mundur që kjo ngjarje të mbetet e gjallë edhe në ditët tona pas 107 vitesh.

veprimtari të tilla e mbajnë të gjallë

krahinën e Pultit dhe respektin për historinë e lavdishme të Pultit dhe dëshmorëve të Planit. LAVDI DESHMORËVE!

Vilson Peshkaj



# Me 21 korrik 1925- Lindi, Martin Camaj, shkrimtar dhe akademik shqiptar

- Në kuadrin e 97 vjetorit të lindjes së Martin Camajt - Nderi i Kombit -

## Jeta

Martini lindi në Dushman të Dukagjinit, më 21 korrik 1925, në vendin e quajtur Telumë. I biri i Kolë Camës, njëherësh bari e bujk. Tereza, e ama ishte nga Vukaj, Shllak. Lindi i treti ndër shtatë fëmijë. Datëlindja 1927 duket të jetë një gabim shtypi. Vendlindja e tij është "... në një vis të egër, 'ku s'ka shkelë kurrë kamba e kalit', kaq i thyeshëm ashtë ky vend", sipas vetë Martinit. Në vendlindje kaloi dhjetë vitet e para të jetës së tij. Nis të fitojë në mënyrë autodidakte njohuritë e para në shkrim e lexim shqip dhe matematikë. Kjo gjë do t'i binte në sy ish-pagëzuesit P. David Pepës OFM, duke e nxitur të ndërmjetësojë pranë instancave epore në Shkodër, që të ndërmerrnin përpjekje për arsimimin dhe përgatitjen - pse jo - për meshtari.

Në vitin 1935 vendoset përfundimisht në Shkodër dhe fillon të marrë arsim të rregullt pranë kolegjit Jezuit "Xaverianum" ku do kalonte edhe tuberkulozin. Rektor i kolegjit atëbotë qe P. Giuseppe Valentini SJ, prej të cilit mësojmë se arsimin fillor 5 vjeçar e kishte përfunduar në 4 vjet. Pesë vitet në vijim ai ndoqi rregullisht gjimnazin, gjë që i dha të drejtën për të vijuar studimet në liceun klasik të kolegjit. I ati vdes pak vite pasi Martini i vogël u fut në Kolegje. Studimet detyrohet t'i ndërprejë në vitin e tretë, më 1946 - mbas mbylljes së instituteve fetare të Shkodrës

Themeloi në Prekal shkollën ku veprroi si mësues i vetëm deri më 1948. Camaj merrte pjesë në rezistencën kundër partizanëve komunistë me çetën e kapiten Gjon Destanishtës dhe në gusht qe i detyruar me jetua në ilegalitet deri sa ia arriti me ikë në Jugosllavi bashkë me At Daniel Gjeçajn OFM dhe grupin e përbërë prej 36 vetash. Kështu nuk pati më rast të kontaktojë me familjen, një vëlla i tij bëri 30 vjet burg. Kryen për tre muaj një kurs intensiv për mësuesinë në Pejë (1 korrik - 30 shtator 1949), mandej punon një vit (1949-'50) mësues në Tuz, në shkollën "Mahmut Lekiq"

Viti 1950 e gjen Martinin në Beograd ku u regjistrua në universitetin e kryeqytetit Jugosllav. Diplomohet pas pesë vitesh më 2 korrik 1955, duke dhënë provime diplome në degën e filologjisë romane me fusha kryesore gjuhë dhe letërsi italiane. Në qershor 1951 martohet, në fillim në bashki, mandej në kishën ortodokse e më pas atë katolike, me mësuesen Nina Bogdanoviç. Pas mbylljes së studimeve në Beograd, Camaj përgatitet për formimin pasuniversitar në albanologji pranë fakultetit filozofik të Universitetit të Sarajevës, i udhëhequr nga albanologu prof. Henrik Bariç - kryetar i Institutit Albanologjik në Sarajeve. Në bashkëpunim me të dhe me mentorin e dytë prof. Rikard Kuzhmiç vendos të promovojë në filologji, duke përzgjedhur si temë doktorate "Gjuha e Gjon Buzukut". Kërkesa

përkatëse e mentorëve të tij miratohet prej këshillit shkencor të atij fakultet në mbledhjen, që u mbajt më 16 shkurt 1956

Po atë vit, duke parë shëndetin në rënie të profesorit dhe gjendjen e rënduar në Republikën Federale vajt në Itali (të paktën qysh më 20 shtator të '56-s), ku e shoqja nga sëmundja detyrohet të heqë një veshkë. I ndihmuar nga Ernest Koliqi dhe profesorëve të vjetër të kolegjit jezuit P. Luigi Rosa dhe P. Zef Valentini atë kohë drejtues i Institutit të Studimeve Shqiptare, si dhe Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe pranë Universitetit të Romës, pasi i njihen studimet e kryera në Universitetin e Beogradit, regjistrohet në vitin e tretë studimor në Fakultetin e Letërsisë dhe të Filozofisë të atij universiteti. Këtu studion letërsi latine, italiane, filologji romane e sllave si dhe gjuhë e letërsi shqipe, ndërkohë pati rastin të ndjekë leksione nga Giuseppe Ungaretti dhe të njohë prej së afërmi poezinë e tij. Nën mentoratën e Koliqit më 15 mars 1960 mbron me vlerësime maksimale pranë Universitetit të Romës, tezën e doktoraturës mbi "Mesharin" e Gjon Buzukut, e cila u botua po atë vit si botim i revistës "Shëjzat", që e redaktonte tash tre vite dhe do ta bënte deri më 1971 nën titullin: "Il Mesale di Gjon Buzuku. Contributi linguistici allo studio della genesi". Gjatë periudhës së studimeve, Camaj ju përkushtua veçanërisht kërkimeve shkencore në terren, në fshatrat e ngulimeve arbëreshe. Qysh më 1959 Koliqi i mundësoi të punojë si lektor pranë Universitetit në Romë, gjë që zgjati deri nga fundi i vitit 1960. Kërkimet akademike të Camajt u përqendruan në gjuhën shqipe dhe dialektet, në veçanti në gjuhën e arbëreshëve të Italisë jugore. Në Romë ndjek rrethet letrare të këtij qyteti, ku njihet edhe me autorët emigrantë nga vende të ndryshme lindore, rusë, rumunë dhe sidomos me poetë baltikë. Ishin të gjithë anëtarë të një PEN-klubi me qendër në Londër.

Në dhjetorin e 1960-s vendoset në



Mynih të Gjermanisë me një bursë dhjetë mujore të dhënë prej fondacionit gjerman DAAD (Shërbimi Gjerman për Shkëmbimin Akademik), për të cilën hyn dorëzanë me rekomandimin e vet etnologu dhe folkloristi Alois Schmaus, që drejtonte atëkohë Seminarin e Sllavistikës pranë Universitetit "Ludwig-Maximilian". Camaj përzgjedh si vend studimi Seminarin e Gjuhësisë, me synimin që të përvetësojë metodat e studimit gjuhësor historiko-krahasues.

Për përfundimin me sukses të kësaj ndërmarrjeje Camaj mbështetet për disa vjet me radhë nga fondacioni i DFG-së (Shoqata e Kërkimit Shkencor Gjerman), i cili i jep një bursë kërkimore, për të mbrojtur gradën e habilitacionit. Këtë gradë e fiton, më datë 21 janar 1965, me vënia legendi në albanologji, duke fituar në të njëjtën kohë edhe të drejtën me qenë Privatdozent - përvojë që e kishte ushtruar si lektor vullnetar, për realizimin e programit universitar, duke dhënë kurse hyrëse të gjuhës shqipe qysh prej semestrit të dimrit në vitin akademik 1961/'62. E shoqja, Nina, e cila jepte gjuhë ruse në

"Bocconi" të Milanos si asistente në vitin akademik 1961/'62 shkon pranë Martinin më 1962, ku ajo do të punojë për pak vite pranë "München American Elementary School" si mësuese dhe bibliotekare. Në vitin 1964, Nina hyn në Urdhnen e Tretë Françeskan, duke marrë emrin Motër Elizabeta. Ndarja përfundimtare me Martinin ndodh në vitin 1968, dhe mbas kësaj date Nina kthehet në Milano ku do të jetojë deri në nandor të vitit 1987.

Prej 1965 deri në 1971 qenë vitet vendimtare për konsolidimin e vatrës albanologjike, duke e vështuar si fushë komplekse të kërkimit shkencor. Më 1969 martohet me Erikën, me të cilën nuk do kishte fëmijë. Më datë 16 korrik 1971 merr emërimin si profesor jo ordinar në albanologji, ndërsa më 14 shtator 1978 emërohet ordinar me marrëdhënie punësimi të përhershëm, më 30 shtator 1990 lirohet nga detyra si profesor i emërtuar[1]. Jetoj në

Lenggries, vend që i kujtonte trojet ku kishte lindë. Vdes më 12 mars të vitit 1992 në Mynih.

## Vepra

Është përfshirë thujse në të gjitha antologjitë dhe veprat ku flitet për shkrimtarët shqiptarë. Kërkimet akademike të Camajt u përqendruan në gjuhën shqipe dhe dialektet, në veçanti të atyre në Italinë jugore. Veprimtaria e tij letrare në harkun kohor 45 vjeçar, ka disa shkallë zhvillimi. Ai e nisi me poezinë, mbas të cilit i mbeti besnik gjithë jetën, kurse gjatë viteve të fundit u përqendrua shumë tek proza. Vëllimi i tij i parë me varg klasik "Nji fyell ndër malë", Prishtinë 1953; "Një fyell ndër malë" dhe "Kënga e vërrinit", Prishtinë 1954. "Kënga e lëndinave", u frymëzuan nga banorët e zonave ku lindi, malësorët e veriut, mbas të cilëve qëndroj shumë i afërt shpirtërisht edhe mbas shumë e shumë viteve në mërgim dhe pamundësia për t'u kthyer. Këto u ndoqën nga "Djella", Romë 1958, një novelë me disa vargje mbi dashurinë e një mësuesi me një vajzë të re. Përmbledhja e poezive "Legjenda", Romë 1964 dhe "Lirika mes dy moteve", Munich 1967, kishte disa poezi nga "Kënga e vërrinit", që u ribotuan në "Poezi" 1953-1967, Munich 1981. Vargu i pjekur i Camajt reflekton ndikimin e lëvizjes hermetike të poetit italian Giuseppe Ungaretti. Karakteret metaforike dhe simbolike të gjuhës së tij rriten me kohën, siç ndodh edhe me rangun e temave poetike të tij.

Një përzgjedhje e poezive të tij e përkthyer në Anglisht nga Leonard Fox në vëllimet "Selected Poetry", New York 1990 (Poezi të zgjedhura), dhe "Palimpsest", Munich & New York 1991.

E paraqiti për botim Lulash Brigja



# Mehmet Shpendi - simboli i qëndresës Shqiptare!

Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me rastin e 107 vjetorit të rënies së atdhetarit Mehmet Shpendi, pranë monumentit të tij, në sheshin e zonës Industriale, organizon kete ceremoni modeste përkujtimore. Muaji korrik është muaji me ngjarje madhore, që e bën Dukagjinin një emër të rëndësishëm në historinë e Shqipërisë. \*Me 10-24 korrik 1910, banorët apo luftëtarët e Nikaj e Merturit u ndeshën me ushtrinë turke nën komandën e njërit nga pashallarët më të fuqishëm të kohës së Perandorisë Osmane dhe në Qafën e Agrit u thye nga forcat e Dukagjinit të drejtuara nga Mehmet (Sokol) Shpendi dhe u detyrua të kthehet në drejtim të Pukës për të hy në Shkodër. \*Korriku i vitit 1915, ishte muaji, në të cilin banorët e Dukagjinit, në veçanti banoret e fshatit të Planit, shpaleshën shpirtin lirisht duke u sakrifikuar me 106 të rënë në këtë rezistencë, në mes të cilëve, 81 të rënë në Plan-

Gjuraj dhe në mes tyre tre gra. \*Në këtë muaj, me datën 15 korrik 1915, vritet edhe atdhetari, Gjenerali popullor, Mehmet Shpendi, bashkë me Çun Nikën e Marash Delinë, që të tre duarlidhur pabesisht. Po sot në këtë kuadër nga administrata e Njësisë Administrative Pult, në Qeresh, është organizuar një veprimtari, kushtuar kësaj ngjarje. Këto ngjarje luftarake për liri e pavarësi na bëjnë më shumë krenar.

Lavdi banoreve të Dukagjinit!  
Lavdi të rënëve për liri!  
Lavdi jetës e veprës  
së Mehmet Shpendi!

## MEHMET SHPENDI (1851 - 1915)

Me dy telat çiftelisë  
Po due kangës me ja nisë  
Me ja nisë e mos me u nalë  
Për një trim në Pecaj - Shalë  
Burrë kreshnik e atdhetarë  
Mehmet Shpëni derë e parë

Djemnisë Shalës ju ka pri  
Në luftë me turk e Mal të Zi.

Me ushtri njajë Turgut Pasha  
Ka kalu shumë male e qafa  
Prej Sulltanit marrë bekimin  
Me qitë fare Dukagjinin  
Që si binet hyqymetit  
Si perulet as ni Mretit  
S’jep haraç, as çon nizam  
Nuk njehë Pashë, nuk njeh Sulltan.

Në qatë të Agrit pushka krisi  
Gjëmojnë malet, lufta nisi  
Mehmet Shpendi me djemni  
Njatë Prël Tulin ka për bri  
Dy dragoj, dy shqipe mali  
Gjylja e topit s’mun i nali  
Rritë në bjeshkë, me orë e zana  
Me shtatë zëmra i patë linë nana.

20 ditë lufta vazhdoj

U derdh gjak e ranë heroj  
Turgut Pasha ngjijë ka ra  
Shumë asqeri ju ka vra  
Ban duva, ka nisë me u falë  
Thotë i gjallë a mujë me dalë  
Çka ka lypë e ka marrë hak  
Me u kthye mrapa i duket pak.  
Mark Milani i Malit Zi  
I pa besë e i pa burri  
Po çon fjalë prej në Cerna Gorë  
Me ba paqe me malsorë  
Përmi Plan kan lanë takimin  
Me ushtri ka ba rrethimin  
Mehmet Shpendin vret mas shpine  
E 70 tjerë prej ksajë krahine.

Pak pa dekë i fjalë ka thanë  
Tokë e qiell ju la dorzanë  
Mos me i dhanë kurr besë anmikut  
Me i dhanë pluma prej çelikut  
Mehmet Shpëni legjendari  
Dot kujtohet djalë mas djali  
Djalë mas djali dot kujtohet  
Gjithmonë kanga do ti knohet.

**Lulash Ara, nga Toplana,  
me banim në Itali**

**Përgatiti Roza Pjetri**

## Një ese e pambaruar për Shkodrën

Mbrëmë u rizgjova nga nderimi për Shkodrën. E kisha larg dhe afër. Aq afër sa mund të kapja me dorë mjegullat e Bunës dhe lulet e lulishtoreve të saj. Të dëgjoja zërat e jetës që kanë një ritëm të pakrahasueshëm me asnjë qytet ballkanik. Të gjithë kemi një Shkodër me vete kur duam të flasim për maja kulture, që jo gjithmonë kanë qenë të pranishme në jetën tonë. E lexova dhe meditova dhe vetë. Erdha për herë të parë në Shkodër më 1967. Isha i ri dhe u bëra më i madh ato ditë. E më dukej se çdo gjë ishte mrekullore. Sa herë që dëgjoj për Shkodrën që shkruaj për të më fanitet Miti i Rozafatit dhe kënga “Eja, eja, lule borë”. Për të qenë i sinqertë, nuk dua t’ia tregoj të gjithë të huajve mitin e saj që ka brenda dhe pak befasi, pak pabesi, por ka dhe shumë sakrificë, poezi, ka mister, ka shumë përfytyrim, ka shumë dhimbje, ka shumë dashuri nëne. Ka shqiptarizëm. Ka besë dhe antibesë. Më tej më vjen një mjeshtëri. Oooo, kur të kalojnë vitet e të rinjtë që nuk e njohën dikur do dëgjojnë për të, do të mësojnë për Njeriun-legjendë të këngës Bikë NDOJA. E dini si thuhet në Shkodër për kangën? “Kush dëgjon kangën e Shkodrës, botën krejt e ka në dorë!” Nuk do koment. Si the ti? Jare, jo, joo, është arie, arie e bukur, është porta e parë ku janë futur operat botërore dhe atëherë kur nuk kishte skena me drita e pa drita, nuk kishte akuistikë, po kishte një Bunë që përcillte si një Danub, si një Vollgë, si një Misisip, si një Nili, si një Jance dertet e botës së shqiptarit që shpesh edhe e kanë thinjur më herët se koha që i jep viti i moshës.

E më vijnë fëmijët e fotografisë së Marubëve, që dolën bash atëherë edhe Evropa sa i kishte nisur hapat e fotove bardhë e zi, të cilat sot të trondisin me vizionin e tyre në Muzetë e Evropës, në Luvër e më tej në sallat e Londrës, Romës,

apo në muzetë bostonianë.

E më vjen historia e çuditshme, por dhe kaq e vërtetë që mund të krijojnë vetëm qytete me tradita të mëdha si asht dhe vetë Shkodra. Ajo e sahatndreqësit, i cili e kishte ruajtur orën dekada të tëra me shpresën dhe korrektesën se një ditë në pragun e dyqanit do të shfaqej ai, i zoti i orës edhe pse mund të vinte nga Gjermania nga Amerika apo nga fundi i botës, që jo vetëm nuk do ta besonte, por çudinë do ia thoshte mbarë botës.

E më vjen ai Zall i Kirit, ku thureshin dashnitë më të bukura të botës, ku shkodranët e merrnin grepin dhe mes **hajgareve** bënin garë me veten në Teatrin e Bejteve Shkodrane të pambaruara. që i kanë dhënë Shkodrës identitetin më të spikatur të gjithë kohërave. E dua t’u them shkodrançe dhe atyre që jetojnë në kopshtijet e saj të mbushura me lule borë, kumbulla, qersh, me avlli ku lulet puthin muret. O sa bukur!

E dua që ta pi këtu me Migjenin kokëkrisur një kafë bash diku në Kafe të Madhe, ta takoj Kolë Idromenon, këtë nip nga Parga e Çamërisë, i cili sapo ka mbaruar perlën shqiptare dhe evropiane “Motrën Tone” apo dhe “Dasmën shkodrane”. Më duket së thërras fort, fort, si një, një monolog të bukur e aspak tragjik si ata të Shekspirat apo të operave botërore, që dikur në këtë qytet hapën siparin për herë të parë. Kush më jep një lule Shkodre, t’ia vë synit edhe gjirit? Do t’i fal thesarë bote, do t’i fal mjaltin e shpirtit. Kush më jep një jare Shkodre, të kndoj kangë- o me bilbilin? Të më lërë pa gjumë sonte përqaftuar me agimin. Kush më jep një fllad prej Bune t’i kreh flokët si ujëvarë? Gjithë paraqsën marr mbi supe, nga dashnia bëhem zjarr. Ballëdjersitur do hedh hapa ta pres ditën në Keshtjelle. Të pi qumësht tek “Rozafa”. Ta bëj zemrën shegë të çarë. Kush i bie

fort këmbanës dhe ezan të ligjërojë? Do të bëhem zog mes dallgës dhe për Shkodrën do këndo. Kush ma shtron një tavë krapin breg liqeni ku loz vala? Le të dehem gjithë nga gazi, të flatroj si pulëbardha. Ndër kangjella ta mbjell këngën si kurorë trëndafilishte. Ja, këtu do bashkoj andrën, do të bëhem farë për brigje. Kush më jep një muzg liqeni ta bëj shall për miken time? E të marr urti kuvendi, si gjerdan me xhevahire? Dhe në gjuhë të ulet bota pranë Bunës, pranë gurit, për një jare që ka Shkodra, le ta vrasë synin e gjumit. Kush më merr ngadalë për dore, të më bredhë në Tarabosh? Do të marr një rreth kurorë, si një mbret do mbretëroj. Kush ma qet kafënë e ëmbël, në Zall t’Kirit ku flet hëna? Zot, o zot, më fut në andërr, për një peng që dot s’e bëra! E them me plot gojë që shkodranisht të flasë bota, se pranë tërvezës vjen magjia. Për atë zemër që ka Shkodra të thurë këngë vetë Perëndia...

O. c’me terratisi gjumi sonte për Shkodrën. Nuk e dija se dikur në Bahçallëk më priste Filip Shiroka, me dallandyshtet e tij si mike të përjetshme. E nuk paska burrë e ilaç që ta kthejë këtë gjumë të prishur. Dhe nuk dua kthim. Jo, se po flas për Shkodrën.

Më të lashtë se dhe vetë gurët që prek.  
O dëshira shkodranishte  
Kush më jep një lule Shkodre  
T’ia vë syrit edhe gjirit?  
Do t’i fal thesarë bote.  
Do t’i fal mjaltin e shpirtit.  
Kush më jep një jare Shkodre  
Për të gjithit hesht bilbili?  
Të më lërë pa gjumë sonte.  
Të përqaftuar me agimin.  
Kush më jep një fllad prej Bune  
T’i kreh flokët si ujëvarë?  
Gjithë paraqsën marr mbi supe  
Nga dashnia bëhem zjarr.  
Ballëdjersitur do hedh hapa  
Ta pres ditën në Keshtjelle.  
Të pi qumësht tek Rozafa  
Ta bëj zemrën shegë të çarë.

Kush i bie fort këmbanës  
Dhe ezan të ligjërojë?  
Do të bëhem zog mes dallgës  
Dhe për Shkodrën do këndo.  
Kush ma shtron një tavë krapin  
N’breg liqeni ku loz vala?  
Le të dehem gjithë nga gazi  
Të flatroj si pulëbardha.  
Ndër kangjella ta mbjell këngën  
Si kurorë trëndafilishte  
Ja, këtu do bashkoj ëndrra  
Do të bëhem farë për brigje.  
Kush më jep një muzg liqeni  
Ta bëj shall për miken time?  
E të marr urti kuvendi  
Si gjerdan me xhevahire.  
Dhe në gjuhë të ulet bota  
Pranë Bunës, pranë gurit  
Për një jare që ka Shkodra  
Le ta vrasë synin e gjumit.  
Kush më merr ngadalë për dore  
Të më bredhë në Tarabosh?  
Do të marr një rreth kurorë  
Si një mbret do mbretëroj.  
Kush ma qet kafënë e ëmbël  
Në Zall t’Kirit ku flet hëna?  
Zot, o zot, më fut në ëndërr  
Për një peng që dot s’e bëra!  
Shkodranisht të flasë Bota  
Pranë sofrës dritëmagjije  
Për atë zemër që ka Shkodra  
Të thurë këngë vetë Perëndia!

**Namik Selmani**



# QËNDRESA POPULLORE E KODRËS SË PALÇIT DHE QAFËS SË AGRIT, KUNDËR EKSPEDITËS NDËSHKIMORE TË TURGUT PASHËS, KORRIK 1910

Pas qëndresës heroike të luftëtarve të Kosovës të udhëhequr nga Idriz Seferi, Isa Boletini dhe Hasan Hysen Budakova në Kaçanik, Caralevë e Budakovë, në prill 1910, kundër forcave të ushtrisë osmane, këto të fundit, me 12 qershor 1910, filluan operacionin në prindim të Rrafshit të Dukagjinit. Duke pas parasyshë qëndresën e fortë që Malësia e Gjakovës i kish bërë një vit më parë ekspeditës së Xhavit Pashës në Qafën e Morinës, në krye të divizionit të dytë që do të sulmonte Malësinë u vu vetë gjenerali më i shquar turk Shefqet Turgut Pasha, i cili u nis nga Gjakova për t'i ra Malësisë.

Plani i komandës xhonturke ishte, që operacioni të kryhej në drejtim të Qafës së Morinës–Qafës së Kolçit–Qafës së Agrit–drejt Shkodrës, ku do të vepronin 18 batalione këmbësorie dhe disa skuadronë kavalerie të përforcuara me bateri artilerie. Ndërkohë, rreth 2000 malësorë nga Gashi e Krasniqja të mobilizuar nën kushtrimin tradicional dhe të prirë nga prijësit e njohur popullor Zeqir Halili, Sadri Bardhi, Halil Brahimi, Abdulla Hoxha e të tjerë. zun pritë në frontin e Qafës së Morinës për të mos lejuar ushtrinë turke të hynte në Malësi.

Turgut Pasha, ashtu si paraardhësi i tij Xhavit Pasha, përdori metodat më të egra shnjorzore për të nenshtuar vendin. Përveç qindra goditjeve me artileri, ai dogji e shkatërroi pothuaj të gjitha shtëpitë e krahinës së Gashit. Në këto luftime të përgjakshme dhe heroike u vranë dhe u plagosën shumë luftëtarë malësor. Forcat operative osmane duke pas epërsi të theksuar ushtarake në numër dhe armatime aritë të hyn në Gash, Krasniqe dhe Bytyç, duke bërë të mundur edhe vendosjen e administratës xhonturke në Malësi. Këto forca pushtuese së bashku me shtabin e tyre drejtues u përqëndruan në livadhin e Fangut të Mulosmanaje, i njohur më pas si “Livadhi i Turkut”, dhe prej aty ushtria sulmonte pa ndërprerje fshatërat, rrëzonte kullat, grabiste bagëtitë dhe kapte e arrestonte kryengitësit, të cilët pasi i turturonte i dënontë me burgim. Ata filluan menjëherë çarmatimin e kryengritësve, rregjistrimin e popullsisë e të pasurisë, mbi bazën e të cilit do të vilesin taksat. Të gjithë burrat nga 16 deri në 60 vjeç u rregjistruan për t'i mobilizuar si rekrut në ushtrinë turke. Njerëzit, veçanarisht të rinjtë, kapeshin nepër shtëpi, dërgoheshin në vendin e tubimit, pastaj transportoheshin drejt Selanikut dhe vendeve tjera të Azisë për të krye shërbimin ushtarak për hesap të turqisë. Për t'u shpëtuar këtyre raprezaljeve: çarmatimin, rekrutimit për në ushtri, rregjistrimit të tokave e bagëtisë dhe pagimit të taksave shumë banorë të Gashit e të Krasniqes qenë detyruar të dalin malit dhe të organizojnë grupe kaçakësh, të cilët herë pas here sulmonin forcat turke. Nga masat që mori qeveria xhonturke me këtë rast



kundër shqiptarëve në Kosovë e Malësi. çarmatimi i përgjithshëm ishte masa më e rëndë që bëri përshtypje të thellë në popull. Kjo masë u hiqte shqiptarëve mjetin më të efekshëm, jo vetëm për t'i rezistuar politikës shtypëse e arbitrare xhonturke, por edhe për të mbrojtur vendin nga grabitëqarët shovinistë serbo-malazezë.

Në vijim të planit të tyre për nënsh-

armëve të armikut. Në kushte të tilla, argumentuan ata, populli do të terrorizohej dhe e tërë krahina do të digjej e plaçketej, prandaj preferuan qëndresë të organizuar me luftë kaçakesh, me sulme të hërëpashërëshme dhe të befasishme. Por Man Avdi dhe Prelë Tuli kishin këmbëngul për një ndeshje të dretpërdrejtë me armikun, prandaj kur po largohej nga kuvendi ky

Prelë Tuli, Man Avdia, Sadik Gjergji e Deli Tahiri, të cilët do të udhëhiqnin luftën kundër një ushtrie të madhe të paisur me armët më moderne të kohës.

Kodra e Palçit do të ishte kryeprita që do të bëhej forcave turke, dhe aty që kishte caktuar Prelë Tuli e Deli Tahiri me dhjetra burra të Salcës, të cilët do të mbronin vendin me çdo çmim. Më në




timin e plotë të “malësive të pabindura” forcat turke bënë organizimin për të sulmuar Nikaj–Merturin e Dukagjinit. Ndërkohë malësorët e Nikaj–Merturit që ndiqnin me vëmëndje ngjarjet e zhvilluara në Kosovë, Gash e Krasniqe, terrorin dhe mizoritë e pashembullta që forcat turke kishin ushtruar kundër popullsisë që organizoi rezistencën heroike në Caralevë, Kaçanik, Rrafshin e Dukagjinit, Qafën e Morinës, Gash, Krasniqe, Bytyç e kudo gjetkë, e shifnin çdo orë e më të afërt mundësinë e ndeshjes me atë furtunë shkatërruese që kish vendosur të nënshtroni shqiptarët. Për t'i bërë ball asaj, në fund të qershorit 1910, rreth 200 burra të Nikaj–Merturit u mblodhën në kuvend të Kodra e Bek Selimit–Lekbibaj. Inisatorët e këtij kuvendi–Prelë Tuli e Man Avdia e të tjerë. u përpoqën të bindin kuvendin që rezistencën kundër forcave të Turgut Pashës ta bënin së bashku dhe të përqëndruar në Qafën e Kolçit. Por kjo nuk u arrit. Shumë pjesëmarrës argumentuan se krahina nuk kishte forca që mundë të përballëshin me një ushtri moderne të asaj kohe siç ishte ajo e Turgut Pashës. Malësorët nuk kishin as minimumin e

i fundit kishte thënë: “Do të gjendet një qafë tjetër ku turku ka për t'u ndesh me armët tona”. Lidhur me këtë këmbëngulje të Prelë Tulit, kronisti i asaj kohe Kamilio Libardi, do të shkruante: “Shkaktari e frymëzuesi i këtij qëndrimi armiqësor kundër qeverisë turke ishte Prelë Tuli i Salcës, një shqiptar i vërtetë nga origjina, nga fama e nga bëmat”. Ndërsa revista Hylli i Dritës 1937, kur përshkruan qëndresën e vitit 1910, duke shkruar: “Prelë Tuli, ai Leonidhë i maleve, doli përpara ushtrisë më të madhe të kohës me një grusht malësorësh”.

Pas kuvendit të Lekbibaj, një kuvend tjetër do të organizohej. Ai i fshatrave Salcë, Palç e Brisë, ku u lidh besa për qëndresë kundër forcave turke. Kuvendi zgjodhi shtabin drejtues të përbërë nga

jug do të vendosej Man Avdia e Sadik Gjergji me burrat e Palçit, ndërsa më në veri, në Kokdoç e Sukë të Mar Vatës do të zinin pritë burrat e Brisës. Gjithashtu u muarën masa për mbrojtjen e popullsisë, furnizimin e luftëtarve me ushqime e municion dhe vendosjen e lidhjeve me fiset tjera të Dukagjinit. Për këtë qëllim, tre ditë përpara se të niste lufta Prelë Tuli dhe Sadik Gjergji shkuan në Shalë tek kisha e Abatit, ku morën takim me Të parin e Djelmnisë së Shalës–Mehmet Shpendi, famulltarin atdhetar Padër Çiril Cani dhe burra të tjerë të parisë si: Pepë Ndreun, Çun Nikën, Marash Delinë, Cukel Delinë, Mirash Ndoun e të tjerë. Këta, në emër të krejt Dukagjinit deklaruan se Dukagjini do të organizonte qëndresë të armatosur në kufij e tij. Pra, Kodra e Palçit dhe Qafa e Agrit do të ktheheshin në epiqendra të rezistencës së armatosur kundër forcave osmane. Ato do të bëheshin dy llogore të pakalueshme për ushtrinë pushtuese.

Me 5 korrik 1910, forcat operative të ushtrisë turke me në krye shtabin e tyre drejtues u nisën nga Livadhi i Bujanit drejt Nikaj–Merturin në dy drejtime: Grupi i parë në drejtim të Geghysenit e Qafës së Kolçit, dhe i dyti, në krye



të të cilit qëndronte tradhëtari Ali Begu, në drejtimin Bujan-Rajë-Tetaj dhe Nikaj. Pas disa orë luftimesh të zhvilluara në Qafën e Kolçit, forcat turke nga të dy drejtimet arritën të depertojnë në krahinë dhe të vendosin shtabin e tyre në kishën e Nikajt, prej nga filluan operacionin e mbledhjes së armëve në fshatërat e Nikaj-Merturit. Në kuadrin e këtij operacioni komanda turke thirri përfaqësuesit e fshatërave Palç, Salcë e Brisë, të cilëve do tu kërkohin dorëzimin e armëve dhe nenshtrimin ndaj kërkesave të forcave osmane. Ata, jo vetëm nuk u paraqitën, po dhe i dërguan fjalë komandës turke "Hajde merri armët!" Ky ishte një deklaramospërfillës e kërcënues që tregonte qartë se këto fshatëra kishin vendosur të mos i bindeshin urdhërave të komandës turke. Të indinjuar nga mosparaqitja e krerëve të tre fshatërave, forcat turke, me 10 korrik 1910, sulmuan Kodrën e Palçit. Që në përpjekjet e para në afërsi të Kodrës së Palçit, pararoja e armikut u ndesh në rezistencën e fortë të 70 luftëtarve malësor të prirë nga Prelë Tuli. Lidhur me këtë përpjekje, epika historike-kronike kryesore e asaj kohe thotë: "Qaj Prelë Tuli trim i çartun, / Qet manxerre e vret bimbashin, / Zjerm i gjallë mbas tij djelmnia, / Trim i rrallë ky Man Avdia /..." Prej këtu armiku, pasi la disa të vrarë, u detyrua të ndërroj drejtim dhe mori rrugën drejt Qafës së T'herme nga ku mundë të fuste më mirë në shënjestrën e artilerisë së vet fshatrat Salcë, Brisë dhe Qafën e Agrit. Luftëtarët popullor menjëherë zunë pritën në Kodër të Palçit dhe përqendruan forcat kryesore tek Guri Murg, përballë Qafës së T'hermes, duke u prerë të gjitha rrugët dhe mundësitë e kalimit të forcave armike. Guri Murg, ku ishin mbërthyer fort, si shqipja pas shkëmbit, që për luftëtarët e Palçit, Salcës dhe Brisës u bë fortesë e pathyeshme për forcat armike. "Guri Fatal" e quajtën ata, pasi në këmbët e tij lan shumë të vrarë e të plagosur. Armiku për disa ditë rresht ndërmori sulme të fuqishme kundër pozicioneve të luftëtarve popullorë. Ata goditën me forca të shumta e të përqëndruara të këmbësorisë dhe me artileri, por pa sukses. Sepse malësorët e njihnin mirë terrenin dhe ishin zotër të tij. Këta përdorën me mjeshtëri taktikën e kundërsulmit të shpejtë e të befasishtëm, ditën dhe natën, në pika të ndryshme e me forca të pakta. Siç deklarohet vetë oficerët osmanë, kishin të bënin me një armik që duket në një pikë, sulmon, pastaj zhduket për të dal menjëherë në një pikë tjetër" Ndërsa një korespondent ushtarak i asaj kohe që shërbente në Stamboll shkruante në revistën "Novaja Vremja" të Petërburgut për luftën e shqiptarve: "Luftojnë tue ndjekun një sistem të ri që, po të flasim troç, s'është më luftë e guerileve. Me një fjalë vihet rë se në mënyrën e tyre të të luftuarit ka diçka të re".

Rezistencën heroike të malësorve-qëndrestarë e mbrojtës të lirisë nuk e thyen breshëritë e vijueshme të mitralozave, as gjyket e topave prej çeliku që u hodhën pa kursim mbi ta dhe kullat e tyre. Sipas dëshmisë së një ushtari turk, pasqyryar në kronikat e Kamilio Libardit, "vetëm gjatë një dite ai kishte hedhur nga pozicioni i tij 37 gjyle". Me piskamën kushtrimtare e vendosmëri shqiptari, malësorët mahnitën pashallarët turqë. Kënga popullore me një figuracion artistik mjaft të goditur thotë: "Pasha shkruen letra te mbreti: / Kurr s'kam pa ksi soj mileti! / Qes me top

gjylen ma kap, / Qes me pushkë m'i halakatë! / Mitralozit m'i thotë rrokaç /..."

Po cilët ishin ata prijës e luftëtar trima e guximtarë që ato ditë të nxehta të korrikut 1910, të mbërthyer në shkëmbejt e kësaj toke siç ishte Guri Murg, i kishin dalë ballë për ballë ushtrisë së fuqishme osmane që komandonte Turgut Pasha?! Ata ishin nikaj-merturës. Të gjithë banorët e fshatërave Brisë, Salcë dhe Palç. I madhe i vogël, që nga fëmijët dhe gratë e deri të këqinjtë. Burrat që ishin për pushkë i kishin rrokur ato dhe luftonin në Kodër të Palçit dhe në Gurin Murg, ndërsa të tjerët: dikush sillte municion dhe ushqime luftëtarve, të tjerët bluanin dhe gatuanin e disa të tjerë mbronin bagëtitë nga grabitjet. Të pa harruar, me nder e lavdi jan skalitur në historinë e Nikaj-Merturit emrat e grave nga Palçi, Zojë Markja dhe Lulë Sylja, të cilat u kacafytën me ushtarët turqë e dhan jetën duke mbrojtur pragun e shtëpisë së tyre. Në ato luftime, që vazhduan disa ditë u derdh dhe gjak. Prelë Tuli mori plagë të rënda, Vat Luci, Sokol Toma, Çun Doda, Grime Ndou gjithashtu u plagosën gjatë përlëshjeve me armiqetë në vijën e parë të frontit. Ndërsa Vogël Muslia dha jetën duke mbrojtur shtëpitë e fshatit që të mos i djeg osmani.

Ndërsa, nga Kodra e Palçit e deri në T'herme të Nikajt e në Gurin Murg kërciste pushka, mitralozit dhe topi, nga Kunora, në Qafë të Agrit, të Nërmajens, të Valbonës e deri në Qafën e Pejës kishin zënë pritën Shala, Shoshi, Toplana e gjithë Dukagjinin. Me të kris pushka në Kodër të Palçit trimi i rradhe Mehmet Shpendi kishte lëshue kushtrimin në Shalë e Dukagjin: "O hiq kushtrim se ne ra turku!". E si vetima ishin organizuar e mësy qafat më shumë se 1000 burra të armatosur. Epika historike e ka përcjell brez pas brezi këtë moment heroik me vargjet: "Mehmet Shpendi trim si motit! / Vrik piskati nepërfis, / N'kamë o djelm' heu ndima e Zotit! / Se n'Mertur pushka u nis./...". Ndërsa revista "Hylli i Dritës", 1937, do të përshkruante kështu gadishmerinë, shkathtësinë dhe shpejtësinë me të cilën Dukagjini ju përgjigj thirrjes së Atdheut, duke zënë qafat e duke i kthyer ato në qendresa të pakalueshme për ushtrinë turke: "Në atë bë, në atë lidhje, - theksonte ajo - doli kush kje djalë për pushkë, e nisën me u shpërndalë malit me pushkë e soplata, me shyeten e torrokopë, tuj këndue e tuj qit pushkë si të ishin tuj shkue në dasëm. Puna ma e par kje me zan shtigjet ndër qafa e lugje, me prishë rrugët, me pre e me rrëzue landë për me pengue kalimin, me çil hendeqe, grupa e llogore për me u mbrojtë prej plumbash t'annikut".

Atë ditë kushtrimi fisi i Shoshit kishte natën e Shqurkut, të cilën sipas traditës po e lusnin me miq e bija. Por me t' u ndigjue thirrja kushtrimtare: "O hiq se ra turku!" shoshjanët lan festën, morën pushkët dhe qirinjtë në gji dhe u nisën drejt qafave dhe maleve ku kishin vendin e tyre. Kënga popullore thotë: "Ka dal Shoshi shpi për shpi, / Tuj lut festë me mik e bijë, / Pushkën n'dorë qirat në gji, / Deli Marashi u ka pri, / N'qafë Kunorë kan dal shefi /..."

Duke u mbështetur në përvojën e luftërave të mëparshme, Mehmet Shpendi-udhëheqës i Djelmnisë së Shalës, po dhe udhëheqësi kryesor i kësaj qëndrese antiosmane, do t'i ndante forcat e luftës

sipas zonave përkatëse:

- Luftëtarët e Thethit, me në krye Prelë Gjelogshin, Lekë Currin (Gjeçaj), Kolë Markun e Dush Perën (Fushë), Mar Kolën (Ndërlisa) do të ruanin ditë e natë Qafën e Pejës dhe të Valbonës;

- Luftëtarët e Pecaje, Abatit dhe Pjollit do të zinin Qafën e Nërmajens ku do të ishin: Mehmet Shpendi, Prelë Marku, e Pepë Ndreu nga shtëpia e bajraktarit të Shalës, Çun Nika, Marash Delia e Shytan Nika (me Lekaj), Cukel Delia, Pal Vatush Leka e Mirash Vatë Leka (me Abat), Çun Kola (me Qukë), Prelë Gjelogshi (me Pjoll);

- Qafën e Agrit do ta zinin Lulash Preka e Mirash Ndou (me Vuksanaj), Bejte Ndoci, Shytan Vuksani (me Lotaj), Binak Kola (me Dakaj), Syk Marku (me Nën-mavriq), Çuk Delia dhe Avdi Kola me Gimaj dhe Plan;

- Shoshi dhe Toplana me prijësit e tyre: Gjelogsh Kola (bajraktar), Deli Marashi (prijës), Babun Celi, Balë Gjoni, Mark Milani, Mëhill Nika, Zmal Preka, Shiqer Ndou, Qerim Ndou dhe Rrustem Lulashi, do të zinin Qafën e Kunorës dhe të Shtrëzës. Këtu do të përqendroheshin edhe luftëtarët e Dushmanit: Lulash Dema (vojvodë) me Papaj; Sokol Bala (me Vasaj) e Mirash Prea (me Kokaj). Kështu brenda 6 orëve luftëtarët nga i gjithë Dukagjini, të betuar se, "këtu turku nuk kalon!" kishin zënë çdo shteg e çdo qafë, nga Shtreziqja deri në Qafën e Pejës, duke formuar një front mbi 20 km të gjatë. Lidhur me këtë Padër Çiril Cani - famulltar i Shalës, me 14 korrik 1910, do t'i shkruante kolegut të tij në Shosh P. Kamilio Libardi: "Dje kam kenë në Qafë të Agrit... shaljanët e kan qit cekën me u ba copë e grimë e me qindrue për Atdhe..."

Kështu forcat turke të gjeneralit të famshëm Turgut Pasha u gjetën në ditët më të vështira që nga krijimi e deri atëherë. Fronti i T'hermes nuk po çahet! Përball kishte Gurin Murg, atë fotesë të pathyeshme ku ishin mbërthyer luftëtarët e Salcës, Palçit e Brisës, të cilët sulmonin armikun pa pushim ditën e natën. Fronti tjetër në Qafë të Agrit e të Nërmajens me të shtëna armësh, potërë e zjermnije të ndezura që shkulmonin flakët përpjetë i priste nga çasti në çast. E përveç këtyre, turqit po përballëshin nga dita në ditë edhe me një front tjetër mjaft të vështirë në prapavijat e tyre. Ata vërtetë kishin mundur të hynë në shumë fshatra të Nikaj-Merturit, duke filluar nga Raja e deri në Palç e Peraj. Kishin zaptuar kishën e Rajës, të Nikajt e të Palçit duke nxjerr përjashta famulltarët e kthye ato në gazerma dhe komanda ushtarake, kërkohin çdo ditë çarmatimin e popullsisë, sulmonin kullat e bagëtitë duke grabitur e plaçkitur çfarë mundënin e ku mundnin, por malësorët e këtyre fshatrave nuk ishin nënshtruar. Ata krijuan grupe kaçakësh, të cilat u vunë në mbrojtje të popullsisë dhe të pasurisë duke sulmuar here pas here forcat turke. Objekt i sulmeve të këtyre grupeve, në mënyrë të veçantë, ishin karvanet që vinin me ndihma nga Gjakova dhe Krasniqja nepërmjet rrugës së Qafës së Kolçit, të cilat sillnin ushtarë, municion dhe ushqime për forcat turke. Siç thuhet në "Hylli i Dritës", 1937, "Ndër këto luftime u dan në shëj për trimni bajraktari i Nikajve Sokol Basha, Shytan Brahimi-krye i Nikajt, Gjelogsh Rama i Currajt Epërm, Dedë

Trimi-krye i Merturit, Tunxh Miftari-bajraktar, Sadik Gjergji shpi e parë në Palç e sidomos trimi i Salcës Prelë Tuli, i cili ku me fjalë, ku me urti e burrni diti me trimnue Nikaj e Mertur, tuj pri ai vetë ma i pari në çdo luftim..."

I gjendur në një situat tepër të vështirë pas 14 ditë luftimesh, midis maleve dhe honesh të pa shkelura ndonjëherë nga ushtritë e huaja, ku kriste pushka kundër forcave turke nga Qafa e Kolçit deri në Qafën e Agrit, gjeneralit Turgut Pasha e kish kuptuar më në fund se malësia e Nikaj-Merturit dhe ajo e Dukagjinit ishin të pakalueshme për ushtrinë e tij. Ai nuk e mori dot guximin të sulmonte Qafën e Agrit ndaj urdhëroi Ali Begun të kthehej mbrapsht. Në tërheqje e sipër, duke shfryrë gjithë mllëfin për humbjen e turpeshme që pësoi, ushtria turke dogji dhe shkatërroj plagosen pa mëshirë çfarë zuri përpara. Të tërbuara, si kafshet e egra kur për vdekje, turqët me 22 dhe 23 korrik 1910, ju turrën Salcës dhe Palçit duke i djegur e rrenuar mbi 60 shtëpi. Shkatërruan ekonominë, duke prerë dhe arat me misër të njomë, rrushët dhe pemët. Këtë terror të shfrenuar ata e ushtruan kudo ku kaluan gjatë kthimit për në Gjakovë. Por, gjatë kësaj rruge ata u gjetën edhe në goditjet e herë pas herëshme të luftëtarve malësorë, të cilët u shkaktuan humbje të tjera si në njerëz edhe në materiale. Këtë dështim të turpshëm të ushtrisë turke populli e ka përjetësuar në vargjet e këngës së tij: "Mos pushoni, bini burra! / Anadolli s'po qëndron, / U vu n'tikun nga kufini / Asht ma hana ka kalon, /...Qafës Kolçit rrugës shpumë, / Ku ndjek rruga për në Pejë, / Me ushtri të përgjysmume, / I turpnuem si grue e vejë /..."

Me qëndresën heroike të vitit 1910 kundër ushtrisë turke, krahina e Nikaj-Merturit dhe e Dukagjinit shkruan një nga faqet më të lavdishme të historisë së tyre. Kjo u arrit, sepse këtu në këto male kishte një popull që i printe flamuri kombëtar dhe ideali i lirisë për ruajtjen e vatanit. Qëndresa e Nika-Merturit dhe e Dukagjinit kundër ekspeditës ndëshkimore të Shefqet Turgut Pashës, dhe thyerja e saj këtu në këto male ku ndër shekuj jetonte, punonte e luftonte një popull me mendje të ngulur në liri, ishte flakë e fuqishme në zjarrin e kryengritjes shqiptare të vitit 1910, e cila shënoi fillimin e një etape të re e më të lartë në luftën e popullit tonë për pavarësi kombëtare. Jehona e kësaj qëndrese u përhap kudo në Malesi, Kosovë e mbar Shqipërinë. Ajo fitoj admirim kudo dhe rriti besimin e popullit për fitore të reja. Kjo qëndresë hyri dhe mbeti në historinë e popullit shqiptar si një nga ngjarjet e shënuara të saj.

Në 110 - vjetorin e kësaj qëndrese, ne, pasardhësit e atyre burrave dhe grave që luftuan e sakrifikuan gjithçka për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut, përulemi plot respekt e mirënjohje përpara sakrificave të tyre, por dhe kemi të drejtën legjitime të krenohemi me baballarët, nënat dhe gjyshstërgjyshërit tanë që na lan trashëgim këto faqe të lavdishme të historisë së kombit.

**Përgatitë nga Dodë Progoni**

**E paraqiti për ribotim**

**Sokol Dedndreaj**

# Ciklet e Hënës dhe si ndikon mbi shëndetin?!

Si ndikon Lunatika mbi natyrën, bimët, kafshët dhe njeriun (mbi emocionet tona)?

Së pari, duhet të dini diçka për planetin Hënë, sateliti i tokës. Ky satelit përshkon qiejt e tokës, duke u rrotulluar rreth saj në mënyrë periodike, duke i paraqitur tokës të njëjtën faqe, atë të ndritshmen, pasi ajo lëviz në të njëjtin drejtim me token.

Hëna ka largësi nga toka – maksimale = 405 500 km e minimale = 363.300 km


Masa e saj është sa 0.123 në raport me token.

Diametri i Hënës është 3 476 km.

Temperature është +/- ditën = +130° C, natën = - 180° C

Po të shohim prejren tërthore të Hënës kemi tre shtresa: Bërthama me materiale hekuri; mantel prej gurësh të shkrirë sikur në tokë dhe korja –shtrese mbetje – pluhuri gurësh, me të cilët mbulon sipërfaqen e saj.

Shih fig. 1




Vete femrat shpeshherë pyesin veten: Pse në një moment jam e disponueshme dhe sa hap e mbyll sytë (në moment) mund të ndryshojë, kundër, vete mendimeve të mia, nuk jam e çiltër, kjo është një reaksion shpërthyes, i cili vjen nga

ka ndryshim karakteristik dhe tek njeriu me lëkundje humori një dite përqendrohet në një mendim pozitiv, një dite pas i njëjti person shfaq mendime negative të pasportueshme saqë më vonë, nuk i pranon as vete. Pra, sikur diçka të tërheq

**Faza e Hënës (Lunatika):** Hana lëviz rreth tokës në të njëjtin drejtim me atë që lëviz vete planeti ynë. Për afro 29 dite ajo bën një rrotullim të plote rreth vetes dhe ndriçimi prej diellit varet nga orbita e saj.

Kur dielli ndriçon faqen e saj të ndritshme plotësisht kemi fazën e Hënës së plotë (e kuqe, e zjarrte), kur dielli i bie faqes së pasme ose nuk e shohim fare (hane sos) ose e shohim si drapër (në rritje hana e re). Pra, kemi maksimumet dhe minimumet e saj.

Shih fig. 2 (faza 7 ditore e Hënës)



fazat e Hënës. Francezet kane një shprehje: gratë (femrat) mendja shpeshherë u ndërton, është i marre kush u beson (Les femmes souvent varies il est fouille qui les croies).

Kështu ndodh, që të nesërmen pendohehet për rrëfimet dhe me një tufë karafila ose lule i drejtohet kolegut si kërkese falje dhe sqaron çështjen. Emocionet irracionale e të rrëmbyera nuk është e lehte të kuptohen, por nëse Hëna ka një fare force vetë tërheqëse mbi pjesën ujore të saj kjo ndodh dhe mbi njerëzit pasi 65% e trupit tonë është ujë, po a ndikon mbi humorin e gabuar?

Në detin e trazuar me dallge të mëdha e batica e zbatika ku peshkohet levreku,

nga jashtë me agresivitet të papritur ose duket e izoluar. Duket se, të katër fazat e Hënës veprojnë mbi energjinë e çdo qenieje të gjalle. Nëse Hëna është e vogël në rritje favorizon ndërhyrjet (operacionet) kirurgjikale, sepse mendohet se hemorragjia (gjakderdhja) është e vogël dhe proceset pastruese të favorshme në saje të Hënës në rritje, që i shton mundësitë shëruese organizmit ndihet më i fortë, më energjik. Deri me 2013 nuk ka pasur asnjë studim shkencor, që të nxjerr në pah fazat Hënore.

Me 2013 studiuesit kanadez të universitetit “Laval” kanë ballafaquar të dhënat e shtrimeve në urgjencë, në fazat e ciklit Hënor, dhe nëse nuk kane gjetur lidhje

ndërmjet krizave të ankthit dhe netëve me Hënë të plote, kane konstatuar si të besueshme: rritjen e çrregullimeve psikike në netët, në të cilat sateliti – Hënë është si glob i zjarrte për pjesën me të madhe të popullimit të të sëmurve dhe në 80% të infermiereve dhe 63 % të mjekëve dhe sido që të jete e vërteta, kjo është e besueshme. Mundësi misterioze e Hënës rrjedh nga pjesa e ndritshme e saj nga cikli lindje – vdekje sipas mitologjisë greke. Pra, ka një vije ndarëse ndërmjet botes së korruptueshme në tokë dhe asaj qiellore të përjetshme e të pa korruptueshme, që i jep jete mitit dhe legjendës. Mitologjia mbështjell faqen e ndryshueshme të Hënës. Misteri, që sheh Selene, mbretëresha e plote e mitologjisë greke, motra e Elios dielli e Eros, zanafilla martesës së Zeusit, kishte një lidhje me Pan e bukura Elide.

Po të kthehemi tek Hëna dhe potencia e saj veçse në det kemi rritjen e disa specieve vegjetale në trupat qiellore, ka veti dhe influkse meteorologjike dhe sizmike të pakrahasueshme.

Perse ujqerit ulërijnë në Hënë?

Shpjegohet nga një legjende indiane. Një natë korriku, megjithëse Hëna ishte e vogël, në zbritje, çereku i fundit ulërinte i dëshpëruar në kohën e Hënës së plote perse ulërin? Kjo shpjegohet se ka humbur një këlysh ujku tani në Hënë e plote si glob i zjarrte i ndritshëm shihet këlyshi buze një gremine, babai ujk e kap dhe e përfaqon dhe kështu ujqerit festojnë me ulërimë Hënë e plote. Dhe për influksin sizmik mendohet se ka lidhje midis tërmetit e aktivitetit lunar, sidomos me fenomenin detar. Kur Hëna ndodhet ndërmjet diellit dhe tokës nuk shikohet, ajo tregon faqen e saj të errët. Pra, Hëna “sos”. Energjia e saj para Hënës së re është më e shënuar, pastaj vjen e rritet deri sa behet glob i zjarrte, 14 dite Hëna e re mund të jete pak e ashpër, pastaj për 14 dite e disa ore Hëna vjen duke u zvogëluar me hark nga e kundërta e rritjes. Pra, nga lindja duke u rritur hija e errët nga e djathta në të majte deri sa nuk do të shihet më Hëna sos.

Veç skeptikeve, që besojnë vetëm në atë, i cili është provuar në bote ka vend dhe për të menduar se energjia konsumohet, humb, rinovohet, rrjedh, rigjenerohet në trup dhe në univers si një fryme vitale, që kinezet e quajnë “Ki” dhe indianet “Prana” dhe që Hëna kontribuon në harmoninë ndërmjet mendjes dhe trupit midis psikikes e somatikes. Fazat Hënore ndikojnë organizimin human, psikiken shëndetin. Pra, njerëzit ndiejnë influksin determinues të rrotullimit të Hënës rreth tokës gjë që ndjehet edhe tek kafshët dhe bimët.

Po t'i referohemi mjekut antik grek Hyppokratit, katër shekuj para JC Krishitit, i cili shpjegonte “Është shokuese, tronditëse të ushtrohet mjekësia pa marre në konsiderate dobinë e lëvizjes së yjeve”. Johana Pongger Poppe Thomas Pope autor i “Il potere di Luna”. Brez pas brezi është trashëguar se Hëna ndikon me pozicionet e saj zodiakale. Kjo ka rendësi për krasitjen e hardhive, të pemëve frutore, për hedhjen e farës, vjelja e rrushit, të korrat, futja e verës në shishe e taposja e saj, ngjasojnë dhe disa ritual magjike që tingëllojnë, të çuditshme, që të katër fazat e Hënës kane influks mbi psikiken mbi trupin.

# Pse njerëzit inteligjentë nuk janë të lumtur?

Eshtë i mallkuar njeriu inteligjent? Kështu duket.

Shumë psikologë mendojnë se, njerëzit, me IQ të lartë (kuotë të lartë të inteligjencës), vuajnë më shumë nga depresioni dhe, bëjnë një jetë mizerabël. Eshtë arritur përfundimisht në konkluzionin se, njerëzit e zgjuar, edhe nëse kanë një karrierë të mirë dhe një familje model, ndjehen të stresuar dhe, më pak të lumtur se, mesatarja e njerëzve.

Një masë e madhe inteligjence, mund të shkaktojë mungesë të inteligjencës emocionale, gjë kjo që sjell ndjenjën e vetmisë dhe, të pakënaqësisë.

Inteligjenca ka të mirat dhe të këqiat e veta. Ajo të bën të suksesshëm në karrierë, të njohur, të respektueshëm, të siguron vendin e nderit, në sofër dhe tavolinë. Por?

Nëse mjafton vetëm kaq që, njeriu, të ndjehet i lumtur në jetë?

Sigurisht që jo.

Që njeriu të ndjehet vërtetë i lumtur në jetë, i duhen emocionet pozitive të cilat, kanë një spektër të gjërë. Mendimtarët e thellë dhe inteligjentët, e përceptojnë jetën dhe, mardhëniet sociale, krejt ndryshe nga të tjerët. Ata shikojnë dhe dëgjojnë gjëra të cilat, të tjerët (tipat e plogët nga mendja dhe shpirti), nuk i kapin dot me shqisat e tyre. Kjo i bën të mendojnë se, në jetë, ka shumë gjëra të tjera, përveç suksesit, karrierës dhe familjes së gëzueshme, që e lumturojnë njeriun. Kjo është që, ata, i bën të pakënaqur, deri edhe depresiv, në jetë.

Tipat inteligjent, zakonisht, nuk janë besimtarë por, i njohin dhe respektojnë me fanatizëm „Dhjetë Urdhëresat Qiellore“. Liria, e drejta, morali, etika, ligji, janë veçoritë pozitive, kryesore, tek ata. Ata munden vetëm aq sa guxojnë, nuk e kalojnë kurrë vijën e kuqe. Individët anarhistë dhe, turmat vandale, që guxojnë gjithçka munden, që nuk njohin moral, etikë, ligj dhe, që nuk respektojnë lirinë dhe të drejtat e të tjerëve, i bëjnë të vuajnë, deri në semundje të rënda psikike.

Psikologët kanë arritur në përfundimin se, tipat inteligjentë, me IQ (kuotë inteligjence) të lartë, janë më të prekshëm nga çrregullimet psikike. Tipat inteligjentë, shumë prej tyre, priren nga dëshira e vetizolimit, vetëmbylljes.

Psikologeja amerikane, Ruth Karpinski thotë se, njerëzit me IQ të lartë, me siguri që vuajnë nga çrregullime të humorit dhe ndjenja e frikës. Studio Pitzer Kolleg, që drejton ajo, eksperimentoi 3700 tipa, me kuotë të lartë të inteligjencës. Konkluzioni ishte se, tipat inteligjentë, janë shumë

më të rrezikuar nga semundje të ndryshme psikike dhe fiziologjike. Dhjetë përqind e tipave me IQ mesatare, vuajnë nga çrregullime psikike dhe ndjenja e frikës. 27 përqind e të anketuarëve vuanin nga çrregullime të humorit, çrregullime bipolare ose nga një gjendje depresive e rëndë dhe, rreth 20 përqind vuanin nga ndjenja e frikës.

Një studio tjetër, nga eksperimentet dhe anketimet me fëmijë, arriti në konkluzionin se, fëmijët e moshës 6-12 vjeç, me IQ të lartë, kur rriten, shpesh vuajnë nga depresioni.

Psikologët mendojnë se shkak është „Efekti Duninng-Kruger“, një nxitës i brëndshëm i cili i nxiton njerëzit inteligjent, për të ditur, gjithnjë e më shumë, për botën që i rrethon. Eshtë një „marifet“ psikologjik, i cili, e bën njeriun inteligjent të dyshojë se, sa më shumë që din për botën që e rrethon, aq më paki i duket se din dhe, aq më i pasigurtë ndjehet.

Tipat e plogët, me varfëri mendore dhe shpirtërore, janë komplet të kundërt.

E thënë thjesht: Të plogtët, nuk e

kuptojnë sa të plogët janë, varfërinë e tyre mendore dhe shpirtërore, ndërsa inteligjentët, gjithmonë dyshojnë në njohuritë e tyre. Tipi i plogët e ruan status quon e vet, inteligjenti është gjithmonë në kërkim të së resë, për më shumë, më shpejt dhe, më lart.

Ka ndonjë shkak tjetër që, tipat me IQ të lartë, janë kaq të ndjeshëm dhe të veçantë?

Po, ka.

Psikologu Michael A. Jawer thotë se, shumë nga tipat me IQ të lartë, karakterizohen nga një IE (inteligjencë emocionale) e ulët. Nuk do të thotë se, një IQ e lartë, është dhe një IE e lartë.

Me inteligjencë emocionale, kuptojmë aftësinë e individit për të kuptuar ndjenjat e veta, kontrolluar ato dhe orientuar në mënyrën më të saktë, në komunikimin me të tjerët. Nga eksperimentet dhe studimet e bëra në këtë drejtim, është vërtetuar se, tek shumë tipa inteligjentë, mungon aftësia e të shprehurit të ndjenjave, emocioneve, nevojave dhe dëshirave. Kjo sjell si pasojë paaftësinë e tyre për të ndërtuar

lidhje të ngushta dhe, aq më pak, për t'i mbajtur ato për një kohë të gjatë.

Nuk ka asgjë për t'u çuditur nëse shikojmë vetëm në tavolinë apo në shtëpi, një njeri të menduar shumë inteligjent. Sigurisht ai mendon se, kjo botë, nuk është aspak në gjendje të kuptojë mençurinë, ndjenjat dhe vlerat e tij.

Monotonia dhe mërzitja, janë një shkak tjetër që, i bën tipat inteligjentë të vuajnë. Ata, nga natyra, janë të prirë për të qënë sa më aktivë në shoqëri dhe, jetën sociale. Bashkëjetesa e detyruar, me tipat e plogët, të varfër nga shpirti dhe mendja, i mundon ata, mendërisht dhe shpirtërisht. Për të përballuar mërzitjen dhe gjendjen e stresit, shpesh hidhen nga njëri projekt në tjetër, pa përfunduar asnjërin prej tyre. Dështimet ua shtojnë akoma më shumë mërzinë dhe, bëhen të pakënaqur, edhe me vetveten.

**Lekë Imeraj-shkrimtar,  
përkthyes, publicist**



◀ Kështu nëse Hëna është në zvogëlim kërkohet t'u jepen krahëve, për të çuar përpara është një periudhe e mirë, që të këputen lidhjet e kontratave të biznesit.

Nëse Hëna, është duke u rritur ka regjenerim rimarrje forcash, të merren iniciativa, për projekte është moment potenciali, trupit akumulon energji, forcë. Hëna në këtë fazë ka vlerë speciale shoqërohet me fat, plotësim dëshirash, dashuri me shikim të pare.

Kujdes kur në qiell duket një Hënë përgjysmë e holluar kontrolloni ushqyerjen së shëndosheni.

Kur Hëna është e plote si glob i zjarrtë dhe toka është ndërmjet Henes e Diellit çdo qenie e gjallë, njerëzit e kafshët, por edhe bimët perceptojnë forca, sipas ndryshimit të drejtimit, të impulsit të Hënës nga rritja në zvogëlim. Është momenti i forcave maksimale të energjisë vitale – pagjumësi, plaga gjakoset me tepër ka rritje të incidenteve, shpejtohet rritja e

bimëve në kopsht, rriten ndjenjat negative, acarim, kryeneçësi, krenari pra 18 ore, para Hënës plote dhe 18 ore pas saj nuk duhet të merren vendime të rëndësishme.

Pra, Hëna e re, në dy çeruket e saj karakterizohet nga energji rinovuese, në këto dite, duke qëndruar esëll, arrihet maksimumi i rezultateve për detoksikimin e trupit, largimin e helmeve. Në këto ditë gratë mund të kenë influks menstrual, force transformuese, por vitalitet mendor e

fizik minimal. Pra, trupit është i ndjeshëm ndaj fazave Hënore, që zgjasin afro 29 ditë, 12 ore e 44 minuta. Shumë problem për ndryshimet fizike e psikike, në raport me fazat e Hënës, të cilat mund t'i gjeni në librin “Luna Rossa” të Marco Edition, Miranda Gray analizon shumë probleme, të cilat lidhen me fazat e Hënës.

**Punoi dhe përgatiti:  
Dr. Med. NDUE NIKAJ,  
Shkodër**

## \*\*\* POEZI Kumrie Avdyl Shala \*\*\* POEZI POEZI Kumrie Avdyl Shala \*\*\*

**STOIKE E FORTË ÇELIK***(kushtuar doktoreshës Flora Brovina)*

Qëndrove heroinë në çdo furtunë, mbajte qëndrim.  
Ti yll i pashuar që na jepe shpresë.  
Flora jonë doktoreshë  
Vendi kishte nevojë për ty  
Edhe pse vdekjen sa shpesh kërkove  
Por... vdekja nuk erdhi kur the ti, sepse se meritoje.  
As atëherë kur të bënë nam e nishan stoike qëndrove.  
Edhe atëherë kur u përpoqën të ta vrasin heshtjen...  
Ty kurrë s'të vranë as se morën nga ti besën.  
As atëherë kur të futën në një errësirë plot llum,  
as atëherë kur të gozhduan ne mur si plumb.  
Ti kurrë nuk u dorëzove.  
U munduan të te fusin në një lojë tradhtie  
T'jetosh jetën si "fatlume",  
Por... ti zgjodhe rrugën e torturës dhe asaj t'lavdisë  
Sepse lirinë e Kosovës e doje më shumë.  
Atëherë edhe tani ti, je stoike,  
e fortë shkëmb e gurë,  
Ti, moj doktoreshë Flora Brovina,  
Kosova nuk do të harroj kurrë.  
Fytyra e rinisë në ty po buzëqesh,  
e shumë si ty trimëresha e luanesha!  
Vdekjen e sfiduan, sepse ishe shembull ti,  
Heshtjen e patët më të fortë se plumbi,  
edhe plagët më të fuqishme se baroti.  
Me laps e me zemër e shkatërruat armikun,  
Qëndrove stoike e fortë si teh çeliku!!!

**POEMË PËR VËLLAIN TIM DËSHMOR**

Sa e rëndë është dhimbja e shpirtit,  
Të tjerët vështirë e kuptojnë,  
Sa trishtuese është kur të tjerët me habi shikojnë,  
Sehir i bëjnë vetëflinimit,  
Kurse për vete këndojnë këngët e kryetrimt!

Sa e lumtur do të isha sikur edhe unë të isha me ty,  
Të festojmë 22 korrikun, vëlla, ne të dy,  
Së bashku në përjetësi,  
Në vitin 1998 në Lagjen Dardania III,  
Demë, vëllai im, i biri i Avdylit, mbiemri Shalë  
Bellagji i Grabocit të Pejës.

Këto janë shënimet nga shërbimet civile për ty,  
Por kjo nuk ka rëndësi,  
Ti ke dy emra:

ÇLIRIMTAR dhe DËSHMOR  
LIRINË kurorë.

U flijove, vëlla, që të jetojmë ne në liri,  
Kurse ti jeton në përjetësi,  
Jetën s'e kurseve për pavarësi,  
Shtetin shumë e dëshirove,  
Pa fije frike rininë ia dhurove.

Fjalët tua më tingëllojnë dhe sot,  
Sa kjo dhembje që dhe më dhemb përmot:  
S'ka çka më bën armiku,  
Plumbin e ha me dhëmbë!

E tash, dëshmori im!  
Ti atje nuk e di,  
Kanë dalë do çlirimtarë,  
Komandantë e pashallarë,  
Të hipur mbi lapidarë,  
Krejt të veshur me ar,  
Dëshmorët i futin nën hije,  
Me qëllim e me vetëdije.

Ne krenohemi me ty,  
Me shokët tu heroikë,  
Trima e stoikë.

Vëlla, o Demush,  
Si ti nuk ishte kush,  
Shokët s'i tradhtove,  
Në ballë të kolonës qëndrove,  
Sa shpejt bombën aktivizove,  
E shkrepë mbi punktun serb,  
Aty në Dardani III,  
Re i ri edhe ti, Demush,  
Si ti kurrkush,  
Mic Sokol e Vojo Kush,  
Legjenda jote e re,  
Historisë tash po ec,  
Afër fshatit Gorazhdec,  
Mbushur me serbë e shkina plaka,  
Dhe tash po u del flaka,  
Ëndërrojnë bomba në dorë,  
Trima shqiptarë me orë.

Demë, o vëlla Demush!  
Si ti kurrkush,  
Atë natë shpëtove dyzetepesë veta,  
Ushtarë e civilë,  
E trupin tënd të njomë ia fale tokës sonë,  
Lajmi mori dheun:  
Nje djalë Belleje,  
Nga derë e Ali Dushit,  
Nip i Marash Palit,  
Shaljani i Avdyl Shalës,  
Në betejë frontale me bombë në dorë,  
Ra dëshmor,  
U ngrit në lapidar,  
Vëllai im ushtar,  
Sa vëlla, sa çlirimtar,  
Me bombë në dorë,  
Kishte dhe ka orë.

Si ata shtatë Shaljanët e Shalës së Dukagjinit, dikur,  
Po sa rrëbeshe uji kaluan nën urë,  
Demë Demushi sot është i teti Shaljan,  
Sa heronj që ishin, po aq dhe sot janë,  
Por, historia e lirisë këtu nuk përfundon,  
Atdheu gjithonë dëshmorë sfidon.

**RUNGU GJIGANT**

Mos e provo fuqinë  
e trungut tim!  
Nuk mund ta thyesh asnjëherë!  
Rrënjët e tij janë të thella,

të thella shtatë pash nën tokë.  
Edhe nëse degët e tij janë thyer,  
afër tyre ka dalë sythi i ri.  
Andaj, mos garo me të...  
Mos e provo forcën tënde,  
se as kalbëzimi e as vrimëzimi  
s'ekzistojnë në trungun e tij.  
Mos e ushqeni kokën tuaj me mendime të errëta  
se... trungjet me rrënjë të thella jetojnë gjatë.  
Rrënjët e tyre janë të shtrira thellë,  
as me mendje nuk i mbërrinë.  
Andaj, mos u mundo ta injorosh  
fuqinë e trungut gjigant,  
se nën hijen e tij po freskohesh  
që nga fëmijëria.

**TË DUA VËRTETË**

Nuk të harrova as edhe për një çast,  
Sa herë emrin tënd dëgjoj  
e rrahura e zemrës krismën do ta ndryshoj.  
Sikur një çekan që ritmin e ndërton,  
nga krisma e drurit e asaj në xham hapëron.  
Ritmet e zemrës janë me drithërimë  
Mendja seç ikën në lindje e perëndim.  
Atje ku dielli na zëntë të bashkuar  
si dy pëllumba marrëzisht të dashuruar.  
Nëse ti mendon që të kam harruar,  
Ah të lutem largoje nga mendja,  
sepse zemrën time, vetëm ti e ke pushtuar.  
Sa shumë vite ikën  
që kur ishim pranë e pranë  
zemra e as mendja nuk të largoj o xhan.  
Ti je pika ime e dobët,  
Ti je ëndrra e pa shtjelluar  
ti je çdo gjë për mua,  
Ti dhe vetëm ti,  
je frymëzimi im i pa shterruar...  
Një ditë kur të iki nga kjo jetë,  
kuptoje njëherë e mirë  
se të kam dashtë vërtetë!

**REDAKSIA**Kryeredaktore: **LUIGJ SHYTI**

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika,  
Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan  
Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon  
Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi botimin:

**AVOKAT SOKOL  
DEDNDREAJ,  
Tiranë**

